E hënë, 13 dhjetor 2021

[Seancë e hapur]

[I akuzuarit merr pjesë përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëdita.

Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mirëdita. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Së pari, të prezantohen të pranishmit.

Zonja Prokurore, keni fjalën.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Zyrat e Prokurorit të Specializuar sot përfaqësohet nga Cezary Michalczuk, Prokuror; Julie Mann, Menaxhere e Lëndës; Ari Bilota, shtazhiere juridike; dhe unë, Silvia D'Ascoli, Ndihmësprokurore.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtësja e Viktimave.

ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Mirëdita të gjithëve. Ekipi i Mbrojtja së Viktimave sot përfaqësohet nga Marie-Pier Barbeau, Ndihmësjuriste dhe unë

Bashkëmbrojtëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Avokati i Mbrojtjes, keni fjalën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse. Sot, Mbrojtja përfaqësohet nga zoti Betim Shala, Bashkëmbrojtës; hetuesi dhe përkthyesi zoti Fatmir Pelaj; zoti Mustafa na bashkohet me videolidhje; dhe unë jam Julius Von Bone, Kryembrojtës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti Mustafa, a punon në rregull lidhja? Na dëgjoni në rregull?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk arrita ta dëgjoj përgjigjen e zotit Mustafa. Nuk e di a e dëgjoj dikush tjetër? Ah, e dëgjuat. Në rregull.

Zoti Mustafa, ju lutem ta përsërisni edhe njëherë. Ju kërkoj ndjesë.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse, po ju dëgjoj mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, hë për hë unë nuk dëgjoj.

Edhe njëherë ky është një test. Zoti Mustafa, a mund të thoni "provë", kjo është "provë".

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Provë. Provë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

Faleminderit. Në rregull. Tani funksionon.

Ju kërkoj ndjesë, zoti Mustafa.

Në rregull atëherë.

Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit Gjykues numër I.

Përpara se të kalojmë përpara dëshmisë së sotme, dëshiroj që të ngre disa çështje dhe të lëshoj disa urdhra. Do t'u jepet mundësia edhe palëve dhe Mbrojtjes së Viktimave që të ngrenë ndonjë çështje që e konsiderojnë të nevojshme.

E para ka të bëj me planifikim për hapat e ardhshëm procedural në këtë çështje gjyqësore dhe lidhur me këtë do të lëshoj një urdhër gojarisht.

Duke mbajtur parasysh se po i afrohemi përfundimit të paraqitjes së provave nga ZPS-ja, në kuadër të planifikimit, Trupi Gjykues i kërkon ZPS-së të na informojë ne, Mbrojtjen dhe Mbrojtësen e Viktimave për një datë të përafërt apo javë të përafërt kur parashikon se s'do të ketë më dëshmitarë të cilët do t'i thërras; apo material provues të cilat do t'i paraqes, në përputhje me rregullin 129 në Rregullores, në mënyrë që të mbyllet paraqitja e provave nga ZPS-ja.

Trupi Gjykues mban parasysh se ekziston dhe një kërkesë sipas rregullit 153 t; ZPS-së - janë parashtrimet e protokolluara me numër F263 dhe F265 - që nuk kanë marrë ende përgjigje, vendimi për këtë do të dalë këtë javë.

ZPS-ja mund të bëjë parashtrime për kalendarin e mbylljes

së paraqitjes së provave nga ana e asaj gojarisht sot ose nesër ose mund të dorëzojë një parashtrim të protokolluar të shkurtër këtë javë, si ta gjykojë të arsyeshme vetë.

Gjithashtu, dëshiroj që të informoj palët dhe Mbrojtësin e Viktimave lidhur me hapat e ardhshëm procedural.

Mbrojtësja e Viktimave duhet të jetë e gatshme që të parashtroj;, mjaftueshëm paraprakisht përpara mbylljes së paraqitjes së provave nga Prokurori i Specializuar, një kërkesë në përputhje me paragrafët 34, 35 dhe 37 të vendimit mbi të drejtat procedurale të viktimave gjatë gjykimit, që është parashtrimi i protokolluar me numër 152, në varësi të nxjerrjes së një vendimi të Trupit Gjykues për çështje e reparacioneve apo zhdëmtimeve.

Mbrojtja duhet, maksimumi në mbylljen e paraqitjes së provave nga ZPS-ja, të bëjë të ditur nëse do të paraqesë prova në përputhje me rregullin 119 të Rregullores. Gjithashtu, Trupi Gjykues dëshiron, sipas rastit, të informojë paraprakisht Avokatin e Mbrojtjes që duhet të jetë gati që të dorëzojë një listë të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe një listë të provave materiale, përfshirë dhe masat mbrojtëse, që do të kërkojnë, nëse është e nevojshme, brenda dy javësh pas mbylljes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja.

Mbrojtësja e Viktimave dhe Avokati i Mbrojtjes udhëzohen që të bëjnë parashtrime mbi këtë kalendar të përafërt, nëse dëshirojnë, ose gojarisht sot apo nesër ose mund të dorëzojnë

një parashtrim të protokolluar këtë javë, si ta vendosim.

Një urdhër ku do të përcaktohet kalendari më preciz për hapat e ardhshme procedural, në varësi të ndryshimeve të nevojshme, do të lëshohet nga ky Trup Gjykues në janar të vitit 2022.

Së fundmi, Trupi Gjykues thekson se në këtë fazë, kalendari për hapat e ardhshëm është thjesht orientues dhe ka për qëllim vetëm të informojë të gjithë për hapat përgatitorë që janë të nevojshëm.

Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

Tani kam një çështje tjetër për ta diskutuar. Është caktimi i kohës për bërjen e pyetjeve nga Mbrojtësja e Viktimave, kundërpyetjet nga Avokati i Mbrojtjes dhe në një fazë të mëpasshme nga ZPS-ja, për këtë do lëshoj një urdhër gojarisht.

Trupi Gjykues vendos të modifikojë udhëzimet mbi zhvillimin e procedurës në lidhje me kohën në dispozicion për bërjen e pyetjeve nga Mbrojtësja e Viktimave si edhe për kundërpyetjet siç ishte përcaktuar fillimisht në vendimin me numër F170, paragrafët 18 dhe 19, në bazë të praktikës që kemi vërejtur në këta muaj të parë të gjykimit. Për rrjedhojë, Trupi Gjykues vendos se kundërpyetjet nga secila prej palëve, parimisht, të mos zgjasin më shumë sesa bërja e pyetjeve nga pala thirrëse. Kjo nuk cenon të drejtën e palës që bën kundërpyetjet për të kërkuar kohë shtesë sipas nevojës dhe

duke dhënë edhe arsyetimin e duhur. Krahas kësaj, Trupi Gjykues rezervon të drejtën për ta kufizuar kohën e kundërpyetjeve për të shmangur përsëritjet dhe për të siguruar shpejtësinë e procedurës pa komprometuar të drejtat e të akuzuarit. Koha që i caktohet Mbrojtjes së Viktimave nuk mund të jetë më e gjatë sesa një kufi kohor por gjithsesi pritet që të zgjasë konsiderueshëm më pak sesa pyetjet nga pala thirrëse apo kundërpyetjet.

Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

Çështja tjetër ka të bëj; me pjesëmarrjen nga larg si nga avokati, nga përfaqësuesit e ekipeve, nga mbrojtësit dhe nga anëtarët e ekipit në seancat ku paraqiten prova përmes platformës Zoom apo platformave të tjera. Jemi informuar dhe me email që është dërguar në emër të Trupit Gjykues të hënën në 6 dhjetor 2021, ora 18.09 minuta të darkës, që pjesëmarrja nga larg mund të lejohet vetëm në seancë publike për arsye të sigurisë për të ruajtur masat mbrojtëse që zbatohen për dëshmitarët. Sot dëshiroj që të shtjelloj më shumë në seancë publike arsyet.

Trupi Gjykues ka detyrimin që të sigurojë që informacionet konfidenciale të mbrohen në çdo moment dhe masat mbrojtëse për dëshmitarët që ka urdhëruar Trupi Gjykues të zbatohen në mënyrë efektive.

Kur ka seanca që zhvillohen në formë në sesion të mbyllur apo privat, Zyra Administrative mban përgjegjësinë për të

siguruar që informacioni konfidenciale të mos i ekspozohet personave të paautorizuar. Jashtë kësaj salle, Zyra Administrative mund të sigurojë dëshminë nga larg në formë të mbrojtur dëshmitarëve përfshirë dhe dëshmitarët e mbrojtur përmes videokonferencës sipas rregullit 144 të Rregullores dhe sipas udhëzuesit të punës për videolidhjet. Por, personelit të Zyrës Administrative nuk mundet dhe nuk duhet, që t'i kërkohet që të jetë i pranishëm fizikisht në asnjë vendndodhje, qoftë kjo në Kosovë apo në vende të tjera të botës, nga të cilat Mbrojtësit apo anëtarët e ekipit nuk mund të, pra – më falni – lidhen - jo nuk mund - po lidhen me seancat për të kryer një vlerësim të dëshmisë.

Trupi Gjykues, gjithsesi, këtu rikujton se ndonëse një anëtar i ekipit nuk është i pranishëm në sallë, ky person do të ketë qasje në çdo moment në transkriptin në kohë reale të të gjitha seancave, përfshirë edhe ato të mbyllura dhe private dhe mund të komunikoj me postë elektronike dhe të shkëmbejë udhëzime me ata që janë të pranishëm në sallë.

Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

Kam edhe një pikë të fundit për të diskutuar me Mbrojtjen.

Zoti Avokat i Mbrojtjes, na keni dërguar një email më datë 8 dhjetor 2021 në orën 10.29 të paradites duke thënë se nuk keni përdorur asnjë dokument gjatë kundërpyetjeve të dëshmitarëve 1679, 3593, 3594 dhe 4600. Pas verifikimit të

transkriptit, kam vënë re se keni përdorur dokumente gjatë pyetjeve që keni bërë. Kam dy shembuj për shembull, ka edhe të tjerë. Transkripti i datës 22 shtator 2021, faqet 642 deri 645 për dëshmitarin 3593; dhe transkripti i datës 5 tetor 2021, faqet 956 deri në 958, për dëshmitarin 1679, ndër të tjerët. Dëshiroj t'ju rikujtoj, se lista e dokumenteve që gjenerohet nga Njësia e Menaxhimit Gjyqësor dhe ju i jeni përgjigjur një emaili nga Njësia e Menaxhimit Gjyqësor që na e tregon këtë listë, ka për qëllim që të regjistrojë me saktësi të gjithë materialet që janë përdorur gjatë bërjes së pyetjeve dëshmitarëve në mënyrë që Trupi Gjykues t'i përdorë këto, sipas nevojës, në aktgjykim, nëse ndonjëra prej dy palëve, Mbrojtësja e Viktimave apo Trupi Gjykues i kërkojnë që këto të pranohen në prova gjyqësore në përputhje me vendimin për zhvillimin e procedurës paragrafi 37.

Për shkak të natyrës administrative të listave të tilla, kundërshtimet ndaj tyre duhet që të mos dalin jashtë gabimeve zyrtare dhe jashtë saktësisë së procesverbalit.

Zoti Avokat, nuk e di nëse mund t'i sqaroni Trupit Gjykues se ç'keni dashur të thoni me emailin tuaj? Sepse mund të ketë edhe ndonjë keqkuptim për shkak të gjuhës.

Z. VON BONE: [Përkthim] Dokumentet që ju po përmendni janë dokumentet që ka përdorë edhe ZPS-ja. Sepse ne e kemi kuptuar kështu që nuk do të përdornim dokumentet e tjera veç dokumenteve të ZPS-së. Ne kështu e kemi kuptuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Por po flasim për të njëjtin material por jo për të njëjtat pjesë. Kanë qenë të gjitha pjesë të ndryshme që janë përdorur. Ndonjëherë kanë qenë të njëjta dhe e kemi bërë këtë diskutim, por ka pasur dhe pjesë të ndryshme. Ideja në këtë rast ka qenë që ju të verifikonit nëse pjesët të cilat i ka bërë të ditura Njësia e Menaxhimit Gjyqësor në këtë listë, kanë qenë të sakta apo jo.

Dhe kemi marrë disa korrigjime që kanë qenë thjesht lapsuse, domethënë, ndonjë numër faqeje, ndonjë numër rreshti që ka qenë shënuar gabim, kjo lloj gjëje. Por, lista ka për qëllim që të kemi një pamje të përgjithshme që mund të shihet më lehtë për të gjitha pjesët që janë përdorur që të mos kalojmë me imtësi të gjithë transkriptin, sepse janë shumë e shumë faqe. Kjo ishte kërkesa jonë.

Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe ne do të përshtatemi. Do ta kryejmë këtë gjë, një prej këtyre ditëve.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë nuk do të lëshoj urdhër gojarisht, por po ta bëni brenda të mërkurës do të ishte shumë mirë.

Z. VON BONE: [Përkthim] Patjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Shumë mirë.

Kanë palët diçka apo Mbrojtësja e Viktimave për të ngritur në këtë moment?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse. Asgjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Mbrojtësja e Viktimave?

ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti Avokat? Jo. Në rregull.

Tani që kemi mbyllur pjesën e çështjeve paraprake, mund të kalojmë tani tek dëshmia e dëshmitarit të ZPS-së me numër 4674.

Zonja asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin të hyj në sallë.

[Dëshmitari hyn në sallë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti dëshmitar, mirëdita. Mirë se erdhët në Dhomat e Specializuara

DËSHMITARI: Mirëdita dhe mirë se ju gjeta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Maskën mund ta hiqni, zoti dëshmitar.

DËSHMITARI: Ja këtu po e lë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti dëshmitar, si jeni?

DËSHMITARI: Mirë, mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, por përpara

kësaj, kam disa gjëra për t'jua thënë.

Fillimisht dëshiroj të shpjegoj masat mbrojtëse që janë miratuar për dëshminë tuaj këtu.

Ju është caktuar një pseudonim. Që do të thotë se nuk do t'jua përmendim kurrë emrin, por do t'ju thërrasim vetëm me fjalët "zoti dëshmitar", në mënyrë që askush nga publiku të mos t'jua marrë vesh emrin.

Gjithashtu dëshminë do ta jepni me ndryshim të pamjes dhe të zërit, që do të thotë se askush jashtë kësaj salle që ndjek transmetimin nuk mund t'jua shohë fytyrën apo t'jua dëgjoj zërin e vërtetë gjatë dhënies së dëshmisë. Pyetjet dhe përgjigjet që nuk jua zbulojnë identitetin, do të bëhen në seancë të hapur, kjo do të thotë se publiku mund të dëgjojë se çfarë thuhet këtu në sallë. Pyetjet që kërkojnë përshkrim të çfarëdo gjëje që ka lidhje konkretisht me ju apo që kërkojnë përmendjen e fakteve që mund të zbulojnë identitetin, do të bëhen në seancë private. Kjo do të thotë se nuk do të ketë transmetim dhe askush jashtë kësaj salle nuk mund të dëgjojë se çfarë thuhet këtu në sallë. Nëse gjatë seancave të hapura thuhet ndonjë gjë nga e cila mund të identifikoheni, këtë informacion do ta mbrojmë. Dëshmia transmetohet me vonesë, jo menjëherë dhe kështu ne mund t'i heqim informacione të tilla nga transmetimi që do të shohë dhe do të dëgjojë publiku si dhe mund t'i heqim nga procesverbali publik i procesit.

Krahas këtyre masa mbrojtëse, janë miratuar edhe disa

masa të tjera shtesë me kërkesë të Zyrës së Mbrojtjes dhe Mbështetjes së Dëshmitarëve, Zyra e Dëshmitarëve, në përputhje me rregullin 80(4)(c) sipas parashtrimit të protokolluar 280. Këto masa janë: Prania e një psikologu gjatë dëshmisë dhe sipas nevojës edhe asistenca për të lexuar tekste të gjata.

Vendimi i Trupit Gjykues u është bërë i ditur palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave me postë elektronike më datë 10 dhjetor 2021 ora 12.10.

Ju informoj, zoti dëshmitar, se një psikolog është i pranishëm dhe mund t'ju vihet në dispozicion, ndodhet jashtë sallës, nëse do të keni nevojë, gjatë dëshmisë.

A janë këto masa mbrojtëse të qarta, zoti dëshmitar?

DËSHMITARI: Po, po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Zoti dëshmitar, ju kanë thirrur të jepni dëshmi para Dhomave të Specializuara në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës, për ta ndihmuar Trupi Gjykues të marrë vendim. Pasi të bëni deklarimin solemn për të thënë të vërtetën, do t'ju bëjnë pyetje përfaqësuesit e Prokurorisë, që janë të ulur në të majtën tuaj, janë të veshur me atë rrobën ngjyrë vjollcë; përfaqësuesit e Viktimave që janë pranuar të marrin pjesë në proces, janë të të ulur aty; Avokati i Mbrojtjes i zoti Mustafa që e keni në krahun tjetër; dhe në fund ne Gjykatësit anëtarë të këtij Trupi Gjykues.

Zoti dëshmitar, dua të jap tani disa udhëzime sesi t'u përgjigjeni pyetjeve që do t'ju bëhen gjatë dhënies së dëshmisë.

Zoti dëshmitar, ju lutem për sa vijon, dëgjoheni me vëmendje secilën pyetje. Nëse nuk e kuptoni, lirisht mund të kërkoni që pyetja të përsëritet. Duam të na thoni të vërtetën dhe të na tregoni se çfarë keni parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni dëgjuar dhe çfarë keni ndjerë ju vetë. Nëse nuk keni e parë apo dëgjuar ju vetë personalisht por e keni marrë vesh në ndonjë mënyrë tjetër, na e thoni që është kështu dhe si e keni marrë vesh. Mbase nuk ju kujtohen të gjitha hollësitë ngjarjeve dhe kjo është e kuptueshme. Ju lutem, të dëshmoni vetëm për sa ju kujtohet. Mos i merrni gjërat me mend, mos sajoni, nuk ka asgjë të keqe nëse thoni "Nuk e di" apo "Nuk më kujtohet".

I kuptuat të gjitha këto.

DËSHMITARI: Po, po. Shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam edhe disa këshilla praktike për dhënien e dëshmisë, zoti dëshmitar. Të gjitha sa i themi këtu përkthehen dhe regjistrohen, prandaj është e rëndësishme që të flisni afër mikrofonit që keni përpara, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë, që t'u jepni kohë përkthyesve të përkthejnë gjithçka.

Përgjigjen duhet të filloni ta jepni vetëm pasi të ketë përfunduar pyetjen personi që ua bën. Dhe pasi ta ketë

përfunduar pyetjen, numëroni me vete deri në pesë dhe vetëm atëherë filloni të jepni përgjigjen. Kjo pauzë prej pesë sekondash është me shumë rëndësi për të gjithë ne që të dëgjojmë siç duhet, të përkthejmë siç duhet, e të regjistrojmë siç duhet ato që thuhen.

Nëse keni pyetje, nëse ju nevojitet pushim apo nëse ju duhet çfarëdo gjëje në çfarëdo momenti, mos nguroni të ngrini dorën dhe kështu e di që dëshironi të thoni diçka.

I kuptuat të gjitha këto, zoti dëshmitar?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë atëherë. Siç e kërkon atëherë procedura për të gjithë dëshmitarët, zoti dëshmitar, do t'ju lutem tani të lexoni deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Ju rikujtoj se dhënia e dëshmisë së rreme përbën vepre penale që është në kompetencë të Dhomave të Specializuara.

Ja dhatë deklaratën dëshmitarit? Shumë mirë.

Zoti Dëshmitar, ju lutem lexoni tekstin që keni përpara.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm, e ndërgjegjshme për rëndësinë e dëshmisë sime për përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W04674

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit, zoti Dëshmitar.

Tani jeni nën betim pretë thënë të vërtetën.

Do të fillojmë tani me dëshminë e dëshmitarit.

Ja jap fjalën Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Zonja Prokurore, keni fjalën.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Pyetje nga zonja D'Ascoli:

Py. Mirëdita, zoti dëshmitar. Unë jam përfaqësuesja e Prokurorisë e cila do t'jua bëj pyetjet sot.

Zonja Kryetare e Trupit Gjykues jua ka shpjeguar tashmë natyrën e masave mbrojtëse që zbatohen në rastin tuaj. Unë nga ana ime, sa herë që të jemi në seancë publike, do të bëj çmos që t'ju rikujtoj që jemi në seancë publike në mënyrë që çdo informacion që të përmendet të mos cekë të dhënat personale apo identifikuese.

Të nderuar Gjykatës, është mirë që publiku ta dijë që pjesa më e madhe e pyetjeve do të bëhet në seancë private për shkak edhe të natyrës së informacionit që do të kërkoj. Prandaj edhe si fillim ju kërkoj që të kalojmë në seancë private sepse pyetjet e para kanë të bëjnë me të dhënat identifikuese të dëshmitarit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

Zonja Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Zonja Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Zoti dëshmitar, fillimisht të dhënat tuaja personale. A mund të thoni, ju lutem, emrin dhe mbiemrin.

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. Datëlindjen, ju lutem.

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. Vendlindjen, ju lutem.

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. Zoti dëshmitar, do t'ju bëj tani disa pyetje që kanë të bëjnë me gjashtëmujorin e parë të viti 1999. Jemi në seancë të mbyllur, askush jashtë kësaj salle nuk na dëgjon dot, kështu që pa problem mund të përmendni emra, apo mund të jepni edhe të dhënat personale pa problem.

Zoti dëshmitar, ku jetonit ju, banonit ju në prill të vitit 1999?

Pë. Në prill të vitit 1999, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Mirëpo, gjatë luftës, kemi ik në *[REDAKTUAR]* vendi më i sigurtë.

Py. Pra, e kuptoj që familja e rregullt, domethënë,

*[REDAKTUAR]* dhe pastaj në një pikë të caktuar kohe shkuat *[REDAKTUAR]*. A ju kujtohet se kur ka qenë pak a shumë kjo, në prill të vitit 1999, kur keni qenë në *[REDAKTUAR]*

Pë. Kjo dikund fillimi i prillit. Kemi ndejtë tri javë në Grashticë. Tash datat i kam harru vallaj.

Py. Në rregull. A mund të na thoni, ju lutem, se në shtëpinë e kujt qëndronit ju kur ishit *[REDAKTUAR]* në këtë kohë?

Pë. Në *[REDAKTUAR]* ka qenë.

Py. A mund të na tregoni edhe mbiemrin e këtij *[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. *[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, *[REDAKTUAR]* vetëm shtëpia ka qenë thatë. E na kemi ndejtë se jena kanë kallaballëk dy-tri shpija aty. Veç unë personalisht, *[REDAKTUAR]* kam ndejtë. Se ka pasur shtëpia të thata aty.

Py. Po *[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]* qaty. Po. Edhe ata kanë qenë një gardhë në mes *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti Dëshmitar, ju lutem kur flet Prokurorja prisni që të përfundojë së foluri Prokurorja, se në të kundërtën nuk mund të përkthehen mesazhet plotësisht. Faleminderit.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për procesverbal, shikoj që

pjesë e pyetjes sime nuk është regjistruar. Pyetja ime ishte në qoftë se *[REDAKTUAR]* apo jo?
Pë. Jo. Nuk e kemi shumë të afërt me ata. Por është vendi më i sigurtë. Se nuk jam shumë të afërm ata. Janë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Py. Atëherë, a e kuptoj siç duhet kur them që shtëpia ku qëndronit juve ishte shtëpia që i përkiste *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*; është kështu?
Pë. Dy shtëpia kanë qenë aty *[REDAKTUAR]*.
Py. Në rregull. Faleminderit.
A mund të na thoni, ju lutem, se kush tjetër ishte me juve në Grashticë.
Pë. *[REDAKTUAR]* na kemi qenë komplet familja jonë. Ka qenë *[REDAKTUAR]*
Py. A mund të na i jepni emrat e tyre, ju lutem?
Pë. Po, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* edhe ka ik.
Py. Ndonjë person tjetër që e mbani mend nga *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Pë. S'ëm kujtohet tjetër kush ka qenë.
Py. Zoti dëshmitar, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Pë. Po, *[REDAKTUAR]*
Py. Pra, *[REDAKTUAR]*
Pë. Po, po. *[REDAKTUAR]*

Py. Po *[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. A e dini në qoftë se i ka ndodhur ndonjë gjë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* në prill të vitit 1999 ndërkohë që ju ishit në *[REDAKTUAR]*?

Pë. Po, e di shumë mirë. Se ne kemi qëndruar *[REDAKTUAR]* e *[REDAKTUAR]* ka qëndruar me disa djem në fshatin *[REDAKTUAR]*. Kanë ruajtur, kanë ndejtë te shtëpiat.

Py. E keni fjalën për *[REDAKTUAR]*.

Pë. *[REDAKTUAR]* prej neve ka ndejtë atje.

Py. A jeni në dijeni në qoftë se atij i ndodhi gjë ndërkohë që ishte *[REDAKTUAR]* në prill të vitit 1999 ndërkohë që ju ishit *[REDAKTUAR]*?

Pë. Po, po. Po jemi në dijeni ça ka ndodhë. E kanë arrestuar policë të UÇK-së, nga ana e policisë të UÇK-së. Nuk e di kush janë kanë.

Py. Nga e dini këtë?

Pë. Po kemi ndie, se aty kanë qenë prezent shumë njerëz. E kanë -- *[REDAKTUAR]* a kanë t'u ardhë te na *[REDAKTUAR]* me na pa, ata kanë taku në rrugë edhe e kanë marrë e kanë shti në kerr. Janë paraqit policë ushtarakë. S'e di a janë kanë a s'janë kanë.

Py. A ju kujtohet konkretisht se kush ju tha se *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Pra, mund të thoni emrin, mbiemrin apo çdo hollësi tjetër që ju kujtohet?

Pë. Po, po. *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* është e saktë kjo?

Pë. Shumë e saktë.

Py. A e di ti, se nga e dinte ai që *[REDAKTUAR]* ishte arrestuar?

Pë. Po ai ka qenë prezent me të. Bashkë kanë qenë.

Py. Do të thuash *[REDAKTUAR]* ishte *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Pë. Po. Bashkë janë kanë.

Py. Në rregull. Pasi dëgjuat për arrestimin *[REDAKTUAR]*, ju personalisht a morët ndonjë veprim, a bërë ndonjë gjë për të marrë vesh më tepër se çfarë i kishte ndodhur *[REDAKTUAR]*

Pë. Po, po. Si jo. Na kemi *[REDAKTUAR]* në Zllash me marrë vesh diçka *[REDAKTUAR]*, po s'kemi mujtë me kontaktu me të kurrë.

Py. Dhe kur thua "kemi shku", a mund të na e sqarosh pak të lutem se kush ishte tjetër përveç teje që shkuat në Zllash?

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. Po ti vetë a ke shkuar me të disa prej herëve kur *[REDAKTUAR]* ka shku në Zllash?

Pë. Unë nuk kam mujt kurrë me shku se *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* dhe jam kanë i angazhum me të. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* ka qenë.

Py. Për cilën periudhë kohe e ke fjalën kur thua që *[REDAKTUAR]* në qoftë se të kujtohet?

Pë. Këtu folet dikund fillimi i prillit. Prej 4, në mos

gabofsha, 4 prillit. Jo, 1 prill. Prej 1 prillit kur ka arrestu *[REDAKTUAR]* deri më -- nuk po di cilën datë kemi ik te poshtë ofensiva. Ofensiva serbe kur na ka ra kemi ik krejt te poshtë. E jena ardhë në shpi tonë.
Py. Pra, a u ktheve ti *[REDAKTUAR]* në një pikë të caktuar kohe në prill të 1999-s?
Pë. Po, po. U kthyem komplet, krejt.
Py. Mendoj se më herët sot, këtë mëngjes, pra, ju thatë që keni kaluar rreth tre javë *[REDAKTUAR]*.
Pë. Po.
Py. Është e saktë kjo?
Pë. Tre javë kena. Datat i kam harru se tri javë fiks kemi ndejtë.
Py. E kuptoj. A mbani mend ndonjë episod, ndonjë gjë konkrete që ka ndodhur ndërkohë që ti u ktheve mbrapsht në shtëpinë *[REDAKTUAR]*, në shtëpinë tuaj *[REDAKTUAR]*, kam përshtypjen, që do jetë gjysma e dytë e prillit të 1999-s?
Pë. Dikun q'ashtu gjysma e dytë e prillit. Kam harru ofensiva kur qenë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* dhe kemi ik për Prishtinë.
Py. Gjatë kësaj periudhe ndërkohë që ju u kthyet mbrapsht në *[REDAKTUAR]*, përsëri *[REDAKTUAR]*, a kishte ndonjë person që i dha familjes tuaj informacion të dorës së parë rreth fatit të *[REDAKTUAR]*?
Pë. Po. Po. Qatë ditë e kanë ik se ka rrok ofensiva serbe dhe

kanë ik edhe UÇK edhe krejt i kanë lëshu të burgosurit *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* se ishin kanë ba *[REDAKTUAR]* dhe thanë "Neve na liruan – ndoshta po i nguti - edhe *[REDAKTUAR]* që tash e lirojnë". E na pritëm, pritëm deri në mbrëmje. Në mbrëmje ikëm edhe na për në Prishtinë.

Py. Në rregull. Atëhere le ta marrim këtë hap pas hapi dhe do të pyes disa pyetje të tjera më konkrete lidhur me atë se çfarë thatë.

Së pari, e kuptoj që dita e ofensivës, atë ditën kur ndodhi ofensiva serbe, disa të burgosur *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*; a është e saktë kjo?

Pë. Po. Shumë e saktë.

Py. A ishe ti personalisht i pranishëm kur erdhën këta njerëz?

Pë. Po, po. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* dhe janë hi në kolonë me shku për në Prishtinë.

Py. A ju kujtohen sesa vetë ishin këta?

Pë. Baji kanë qenë pesë a gjashtë. Nuk po e di, po harroj.

Py. A i njihnit këta njerëz? A e dinit se kush ishin ata?

Pë. Veç një e njof.

Py. Në qoftë se të kujtohet emri, mund të na e thuash?

Pë. Emri është *[REDAKTUAR]*.

Py. A ju kujtohet ndonjë person tjetër --

Pë. Jo, jo.
Py. -- nga këta personat që erdhe në në shtëpinë tuaj *[REDAKTUAR]*, a ju kujtohet ndonjë person tjetër ?
Pë. Nuk më kujtohet se i kam harru emrat edhe s'i kam njoftë unë. Po këtë *[REDAKTUAR]* e kam njoftë.
Py. A ju kujtohet se çfarë thanë ata? Ju thatë "të burgosur" pse e përdorët këtë term, termin "të burgosur"?
Pë. Pse *[REDAKTUAR]*. Ata treguan që jemi kanë në burg në Zllash.
Py. Dhe më herët sot - po lexoj faqen 19, rreshti 2 - ju thatë që:
"Ata janë liruar edhe që *[REDAKTUAR]* do lirohet gjithashtu".
Py. Çfarë ju thanë ata? Çfarë ju thanë?
Pë. Ata na thanë që "Neve na lirun edhe *[REDAKTUAR]* do të lirohet".
Py. A ju kujtohet ndonjë gjë tjetër që ju thanë ata?
Pë. Ata veç --
Py. Ju thanë që ata kanë qenë në një burg në Zllash?
Pë. Po. Ata na thanë "*[REDAKTUAR]* edhe *[REDAKTUAR]* janë mbetë veç do të lirohen edhe ata" dhe ata *[REDAKTUAR]*.
Py. A thanë gjë ata se kush i kishte burgosur këta persona dhe më vonë i kishte liruar?
Pë. Jo, jo. Nuk më thanë. Veç ata vetë ishin liruar dhe thojshin që "Mbasi jemi liruar ne edhe *[REDAKTUAR]* e lirojnë" se thanë "u mbetë *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]*". Nuk është nuk e di kurrë.

Py. Çfarë do të thuash kur thua "*[REDAKTUAR]*"?
Pë. Dikush nga... [Njerëz që flasin njëkohësisht]
Py. A mund të na e shpjegosh pak më tej?
Pë. *[REDAKTUAR]*
Py. Përpara sesa të arrijmë në këtë pikë, unë ju pyeta se çfarë do të thuash kur thua "*[REDAKTUAR]*"? Sepse *[REDAKTUAR]* është një zonë më e madhe dhe thjeshtë do të dija në qoftë se keni ndonjë informacion tjetër --
Pë. Jo.
Py. -- konkret lidhur --
Pë. Kurrë.
Py. -- me këtë personin që ishte nga *[REDAKTUAR]*?
Pë. Për atë person, unë nuk kam dijeni kurrë. S'kam ditë kush është.
Py. Zoti dëshmitar, ju i keni dhënë një deklaratë UNMIK-ut gjatë hetimeve të kryera prej UNMIK-ut lidhur me *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*. Keni dhënë deklaratë edhe për ZPS-në.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Me lejen e të nderuarve Gjykatës, dua që t'i rikujtoj dëshmitarit disa emra të cilët ai i ka përmendur në këto dy deklarata.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem vazhdoni më tej, zonja Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Unë do të lexoj nga deklarata e UNMIK-ut e dëshmitarit që

mban datën *[REDAKTUAR]*. Numri i identifikimit është ERN SPOE1228189 deri në 0018201. Ky dokument është pjesë e listës në ndarjen 1 dhe do të kërkoja për sekretarinë që të shfaqte faqen 1 në ekran.

Py. Zoti dëshmitar, kërkova që të shfaqet deklarata që i keni dhënë UNMIK-ut dhe do lexoj një pjesë të kësaj deklarate. Mund të dëgjoni përkthimin në kufje, në dëgjuese. Dhe pastaj do t'ju pyes në qoftë se juve ju kujtohet që keni dhënë disa hollësi të tjera përkatëse në këtë deklaratë që keni dhënë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Pjesa është pjesa e fundit, paragrafi i fundit në deklaratën që keni dhënë në faqen 1.

Py. Do lexoj të gjithë pjesën. Pyetja që është drejtuar është kjo:

"A e keni bërë ndonjë gjë tjetër për të gjetur *[REDAKTUAR]*

Dhe përgjigja që keni dhënë ju është kjo:

"Unë kisha dëgjuar vetëm zëra dhe në mes të prillit 1999, përpara sesa u takova me *[REDAKTUAR]*, gjashtë apo shtatë vetë erdhën tek *[REDAKTUAR]*, në *[REDAKTUAR]* dhe thanë që ata kishin qenë të burgosur të ushtarëve të UÇK-së, konkretisht Skifterave, një grup brenda UÇK-së dhe se *[REDAKTUAR]* kishte qenë me ta dhe që ishte ende atje me një person tjetër nga zona e *[REDAKTUAR]*".

A ju kujtohet se e keni thënë këtë dhe a është i saktë ky informacion?

Pë. Po, po. Vetë e kam thënë dhe e saktë është.
Py. Pra, sot më herët na tregove që erdhën gjashtë a shtatë persona, të cilët *[REDAKTUAR]* dhe këtu në këtë paragraf thuhet, që këta persona, pra, të burgosur kishin thënë që kishin qenë të burgosur të UÇK-së dhe konkretisht të Skifterave, një grup brenda UÇK-së.
A e mban mend këtë gjë dhe a është kjo ajo çfarë ju kanë thënë të burgosurit?
Pë. Po kjo është e njëjtë që ai burgi i Skifterave a kanë në Zllash. Qaty s'ka pasë tjetër burg në atë rajon. I njëjti burg.
Py. Në rregull. Do të vazhdoj do të lexoj dhe pjesën e mbetur të paragrafit.
Citoj:
"Ata thanë se burgu gjendej në fshatin Zllash, në një ahër. Unë njoh vetëm -- e di vetëm mbiemrin e një prej dëshmitarëve që është *[REDAKTUAR]* dhe një tjetër që ka një nofkë *[REDAKTUAR]* nuk ja di mbiemrin por ai është një person që e kam njohur *[REDAKTUAR]* dhe jeton në *[REDAKTUAR]*, që aktualisht njihet si zona e *[REDAKTUAR]*. Këta ish të burgosur thanë se të gjithë ata, përfshirë dhe *[REDAKTUAR]*, ishin trajtuar keq. Vetëm se *[REDAKTUAR]* ishte trajtuar më keq se të tjerët".
Dhe këtu përfundoj citimin.
A ju kujtohet se e keni thënë këtë gjë në deklaratën e

UNMIK-ut dhe a është e vërtetë kjo? Ju kujtohet ta keni thënë këtë?
Pë. E vërtetë është. Ajo deklarata që kam thënë *[REDAKTUAR]* tash e kam zbuluar *[REDAKTUAR]* e kish emrin, *[REDAKTUAR]*. Nuk ja kam ditë atëherë emrin *[REDAKTUAR]*. Edhe ai dëshmitari tjetër, ai është diku i *[REDAKTUAR]*. Atë s'e kam pa kurrë më. Se ato tjerët s'i kam njoftë.
Py. Pra, po thoni që personi i cili përmendet prej jush në faqen 19, rreshti 21, në transkriptin e ditës së sotme, quhet *[REDAKTUAR]* dhe që *[REDAKTUAR]* që juve e keni përmendur në deklaratën e UNMIK-ut; është kështu?
Pë. Qa ai. Q'ashtu është.
Py. Në rregull. Dhe pastaj kur i drejtoheni dëshmitarit tjetër, e keni fjalën për emrin tjetër që unë lexova nga deklarata e dhënë nga ju më parë, që është emri *[REDAKTUAR]*
Pë. Po. Atë nuk e njof kurrë. As e kam taku kurrë. A dikun është i lartë, dikun i *[REDAKTUAR]* është.
Py. Nga t'u kujtua emri i tij atëherë? E përmendi ai emrin kur erdhi *[REDAKTUAR]*?
Pë. Për të cilin është fjala?
Py. E kam fjalën për personin që ju thatë që quhet *[REDAKTUAR]*.
Pë. Veç i kemi marrë vesh *[REDAKTUAR]*, emrin ja kam harru dhe kurrë s'e di kush a kanë.
Py. Në rregull. Faleminderit që na e sqaruat këtë.
A ju kujtohen kushtet në të cilat ishin këta njerëz kur

erdhën *[REDAKTUAR]*?

Pë. Këta njerëz kur erdhën te ne *[REDAKTUAR]*, ishin ba sikur majmunat. Thonjtë pa pre, pa u rrue, pa u pastru kurrë. S'di sa po më kuptoni. Që kaq thonjtë i kishin pasë. Pa u rru kurrë. Pa u pastru kurrë. Ashtu janë ardhë te na.

Py. A të kujtohen hollësi të tjera? Të kujtohet ndonjë gjë tjetër nga mënyra sesi dukeshin ata?

Pë. Tjetër nuk më kujtohet. Veç e di që *[REDAKTUAR]* i kanë pre thonjtë, janë rru, janë pastru, janë hi në kolonë e janë ik për Prishtinë.

Py. A i ke ndihmuar në ndonjë mënyrë ti ata ndërkohë që ata ishin *[REDAKTUAR]*?

Pë. Edhe njëherë pyetjen, më fal?

Py. Sigurisht. Juve a i keni ndihmuar ata? I keni asistuar në ndonjë mënyrë *[REDAKTUAR]*

Pë. Ju kemi dhanë bukë, ju kemi dhënë do sende me i pre thonjtë, janë mu rrue dhe kanë ik për Prishtinë.

Py. Dhe a ju kujtohet se për sa kohë qëndruan ata *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Pë. Po nuk po e di. Nja dy-tri orë. Deri në mbrëmje. Tash s'po di.

Py. Lexova nga deklarata që i keni dhënë UNMIK-ut, se ju i keni thënë UNMIK-ut, ke deklaruar që këta të burgosur thanë që janë trajtuar keq dhe se *[REDAKTUAR]* ishte trajtuar më keq sesa ata. A është e vërtetë kjo?

Pë. Ata kanë thënë veç një njeriut i ka thënë në mënyrë të mshefë se neve nuk na kanë tregu që kanë keqtrajtu *[REDAKTUAR]* ata s'ka -- a në mënyrë të msheftë *[REDAKTUAR]* aty dhe tani na kemi marrë vesh që janë trajtu keq.
Py. A ju kujtohet ndonjë hollësi tjetër lidhur me këtë?
Pë. Lidhur me këtë kurrgjë. Vetëm ata janë nisë për Prishtinë ma herët. Na kemi ec në mbrëmje q'atë natë për Prishtinë.
Py. A ju kujtohet se kush ishte *[REDAKTUAR]* apo një prej *[REDAKTUAR]* të tuaj që ata i thanë që ai ishte keqtrajtuar? A të kujtohet emri i këtij *[REDAKTUAR]*
Pë. Emri *[REDAKTUAR]*.
Py. Dhe ky *[REDAKTUAR]* ishte në *[REDAKTUAR]* --
Pë. Po.
Py. -- dhe ishte i njëjti person që fillimisht ishte me *[REDAKTUAR]* kur e arrestuan ky është?
Pë. I njëjti person është.
Py. Pra, i njëjti person. Dhe ky ndodhej *[REDAKTUAR]* kur erdhën këta pesa a gjashtë personat në prill të viti 1999?
Pë. Po, po të gjithë kemi qenë te shtëpia.
Py. Pashë që u përmend dhe emri i grupit Skifterat. E kuptove atëherë se për kë e kishin fjalën ata kur përmendën fjalën Skifterat? E kuptove ti vetë?
Pë. Skiftera unë atëherë mendojsha një -- që janë ushtarë. Ata ishin kanë polici ekip, ça po di unë, polici ushtarake a ça ishin këta.

Py. Domethënë, kështu mendove se ishte ky grup?
Pë. Q'ashtu --
Py. Pse?
Pë. Pse --
Py. Pse e mendove kështu? Ju lutem, prisni derisa ta përfundoj pyetjen.
Pë. Se Skifterat të policisë ushtarake kanë arrestuar *[REDAKTUAR]* nuk është -- edhe kam mëndu që janë qata. Dhe qata janë sigurisht.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull. E kuptoj. Me lejen e Gjykatësve, dëshiroj që të nxjerrim në ekran edhe intervistën që dëshmitari i ka dhënë ZPS-së për të sqaruar se çfarë ka thënë lidhur me këtë.

Py. Zoti dëshmitar, do të lexoj përsëri nga një pjesë e intervistës që ja keni dhënë Prokurorisë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për sekretaren është pjesa e transkriptit numër 2, me numër ERN 076509-TR-ET, RED1. Që është në ndarjen 2. Unë do të lexoj nga faqja 26, rreshtat 1 deri 6.

Py. Zoti dëshmitar, këtu në ekran ka dalë transkripti, po s'ka nevojë ta lexoni ju. Do ta lexoj unë në anglisht dhe ju do ta dëgjoni në dëgjuese përkthimin.

Po filloj të lexoj nga rreshti 1:

"Pë. Kështu thanë. Do të thoshte se këta Skifterat e menaxhonin, domethënë ishin, e drejtonin këtë burgun".

"Py. Dhe a ju dhanë, domethënë, e kuptuat ju se për kë e kishin fjalën ata kur thoshin Skifterat, çfarë ishin Skifterat?"

"Pë. Ishte thjesht një njësit, një njësit i veçantë që quhej njësiti Skifterat. Kështu e kuptova unë".

Pë. Q'ashtu kam kuptu.

Py. Ju kujtohet kjo?

Pë. Q'ashtu kam kuptu. Skifterat janë njësi apet hala e kuptoj që ashtu. Një njësi ushtarake, policore a çka a quajt policore.

Py. Po. Në rregull. Por kështu mendoni se ka qenë kjo njësi; apo jo?

Pë. Po, sigurisht.

Py. Edhe sot, sot më duket se thatë. Po lexoj nga teksti i zbardhur i seancës sot:

"Është se -- nga që policia ushtarake e arrestoi *[REDAKTUAR]* mendova se janë të njëjtët persona".

Pra, kjo është ajo mbi të cilën mbështeteni, bazoheni për të dhënë këtë përgjigje?

Pë. Q'ashtu unë e kuptoj. E njëjtë si polici ushtarake si Skifterat një.

Py. Në rregull. Rastësisht mos e dinit gjë kush -- a e dinit kush ishte komandanti i këtij grupi të quajtur Skifterat?

Pë. Jo, as nuk e kemi ditë atëherë kurrë.

Py. Po më pas, më vonë a e mësove se kush ishte?

Pë. Po ma vonë fjalë. Q'ashtu fjalë. Dikush thojke ashtu, dikush ashtu. Veç fundi qato e dinë se ata Skiftera i kanë përmend. Sa është e sigurtë nuk e di unë. Vetë s'kam qenë aty.
Py. Po emrin Salih Mustafa a e njeh?
Pë. Po e njoh tash përmes televizorit se në fillim nuk e kam ditë. Emri Mustafa, mbiemrin e kam ndi, fjalë thojshin a kanë atje komandant. Tash prej që u dal në gjyq po e di edhe emrat.
Py. E bëj këtë pyetje sepse në deklaratën që ja keni dhënë UNMIK-ut, është deklarata e datës *[REDAKTUAR]* me numër SPOE00122889 deri në 00128201, në faqen 9, këtu ju kanë bërë pyetjen:
"A e njihni emrin Salih Mustafa?"
Dhe ju i jeni përgjigjur:
"Po, e njoh emrin Salih Mustafa, kam dëgjuar se është komandant i Skifterave dhe është nga fshati Rimanishtë".
Të kujtohet?
Pë. E vërtetë është q'ashtu si thuhet. Veç kam dëgjuar atëherë për emër bile-bile mbiemrin tani dikur. Veç emrin, mbiemrin vonë e kam marrë vesh.
Py. Për ta sqaruar. Kur e keni thënë këtë në deklaratën që ja keni dhënë UNMIK-ut, këtë informacion që ishte komandant i Skifterave dhe që ishte nga fshati Rimanishtë, ky ka qenë një informacion që e keni marrë vesh dhe e keni marrë vesh më vonë; kështu?
Pë. Dhe po harroj unë. Tash s'po më kujtohen me qit. Këto me

të ndime. Këto kam ndi unë. Vetë s'kam qenë as ushtar, as në Zllash, as hiç. Me të ndime e kam ndi q'ështu dikur Mustafa, diku Salih Mustafa, dikush Cali. Nuk di.

Py. Është e qartë. Faleminderit, që na e sqaruat. Do të kaloj tani në ca pyetje të tjera. Kanë të bëjnë këto pyetje me atë se çfarë i ka ndodhur si përfundim *[REDAKTUAR]*.

Kur e mësuat ju se çfarë i kishte ndodhur *[REDAKTUAR]*?

Pë. Na atë ditë kemi ik për Prishtinë të tanë, dy muaj ditë kena ndejtë në Prishtinë. Mbas dy muajve - po gjatë bombardimeve domethënë - mbas dy muajve jemi kthy në katund. Edhe na e lypshim *[REDAKTUAR]* dikun gjallë, kemi mendu që është i gjallë *[REDAKTUAR]* gjithherë. Edhe mbas nja një jave që jena dal në kah *[REDAKTUAR]* i ka thënë dikush që "*[REDAKTUAR]* nuk e ke gjallë, po shko lype dikund rreth burgut atje ndoshta e gjen". E atëherë ne kemi fillu me lyp *[REDAKTUAR]* të vdekur, se kemi mendu që i gjallë është.

Py. A e dini, a ju kujtohet se kush i kishte kallëzu *[REDAKTUAR]* nuk ishte më gjallë?

Pë. Jo, se s'ka dashë *[REDAKTUAR]* me më tregu atëherë. E kam pyetur "Kush të tregoj? Kush të tha?" Nuk ka dashtë me na tregu.

Py. Po ti *[REDAKTUAR]* çfarë bëtë, nëse bëtë ndonjë gjë, mbasi e morët këtë informacion?

Pë. Po, po. Unë *[REDAKTUAR]* dolëm me e lyp për të vdekur tani. Morëm traktorin, do lopata dhe shkuam në Zllash. Shkuam

më s'pari burgun e këqyrëm, e gjetëm në podrum aty në një stallë e kafshëve. Naltë kishin pasë ndejtë ushtarët sigurisht. Edhe gjetëm një dokument *[REDAKTUAR]* që ka qenë në spital një fletë-lëshim edhe një regjistër të ushtarëve që kanë qenë ushtarë të UÇK-së, ndërrime qysh ishin bë. Ca dokumente gjetëm aty. Stalla thatë. Edhe dolëm përreth shtabit, rreth atij shtabi dhe e pamë një tube me dhé q'ashtu të madhe. Shkum e shplojmë ngadalë. Unë e kam shplu. Më së pari më ka dalë -- se dul një qebe aty, si e shplumë pak dul qebe, një fytyrë e panjofshme aty. A s'keka *[REDAKTUAR]* s'keka *[REDAKTUAR]* Tash tha të shplojmë mandejna ma shumë. Kur e kena shplu ata ishin kanë bashkë. Edhe veç në dhëmb e kam njoftë *[REDAKTUAR]* e kemi dashtë shumë.

Py. Këtë, këto që sapo i thatë.

Po në rregull. Po vazhdojmë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni, zonja Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

Py. Zoti dëshmitar, e nisa po thosha që lidhur me këto që sapo na i thatë i kam disa pyetje.

Pikë së pari, na treguat këtu se ti dhe -- pra, ju dhe *[REDAKTUAR]* shkuat në Zllash. Po nga e dinit ju se ku pikërisht të shkonit në Zllash?

Pë. Po e dijshëm se *[REDAKTUAR]* ka shku në Zllash për çdo ditë.

Py. Pra, a ishte *[REDAKTUAR]* ai që jua tregoj rrugën me shku në Zllash që po tregonte se ku me shku?
Pë. Po, se unë s'kam qenë në Zllash. Hera e parë që kam shku.
Py. Nuk kishit qenë kurrë në Zllash përpara kësaj here që shkuat me *[REDAKTUAR]*
Pë. Unë jo.
Py. Shkuat *[REDAKTUAR]* në një vend të veçantë në Zllash. E thatë këtu më lart në rreshtin e 18, faqe 28 të transkriptit thatë "Gjetëm ndërtesën e burgut, ahrin në katin përdhes dhe në katin sipër vendi ku rrinin ushtarët dikur më përpara".
Si e gjetët juve këtë ndërtesë të burgut, domethënë, ti bashkë *[REDAKTUAR]*?
Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* por kurrë s'e kanë lënë me pa.
Py. Në rregull. Mbërritët në ndërtesë. Çfarë bëtë aty pastaj kur shkuat te kjo ndërtesa?
Pë. Kurrgjë. I gjetëm q'ato dokumente. U sillem kurrgjë dolëm rrethit rreth burgut e kërkuam derisa e gjetëm q'atë turbën me dhé.
Py. Pra, siç e kuptoj. Hytë brenda në ndërtesë --
Pë. Po.
Py. -- atë që e quanin ndërtesë e burgut?
Pë. Po. S'kish pasë kurrgjë aty.
Py. Dhe në cilën pjesë të ndërtesës hytë?
Pë. Ma së pari kishim ra podrumit. Katin përdhes, podrumin ma

ndej dolëm naltë përmbi podrum të ndërtesës. Aty gjetëm do dokumente, do sende.

Py. Zoti dëshmitar, do t'ju tregoj tani disa fotografi që i keni parë më përpara. I patë gjatë intervistës me Prokurorinë. Ndërkohë derisa këto dokument të dalin, nuk e di nëse asistentja e sallës mund t'ju jap, po, t'ju jap kopje në letër të këtyre fotografive në mënyrë që të shkoni në faqen përkatëse.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ndërkohë zonjës Sekretare, i lutem që të nxjerrë dokumentet që janë në nënndarjen 8 të materialeve, me numër SPOE00128386 deri në 00128420. Dhe më duhet faqja 3, që është me numër SPOE00128388. Ta paraqesim në ekran, ju lutem.

Py. Zoti dëshmitar, ndërkohë hapni -- ju lutem, shihini fotografitë, këqyrni fotografitë.

Pë. Po, po.

Py. Fotografitë mbajini aty sepse do t'i shohim më vonë ato. Por tani këqyrni ekranin dhe më thoni nëse e njihni çka duket aty në fotografi që ka dalë tani në ekran.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa për t'u sqaruar, i kam dhënë dëshmitarit një lidhje me fotografi që t'i përdor më pas.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më pas dëshiroj edhe unë t'i shikoj ato fotografi. Dhe mirë do të ishte që t'i shihte edhe Mbrojtësja e Viktimave dhe Avokati i

Mbrojtjes.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Patjetër. Ua kam dhënë në fillim të seancës. Po ka ende kohë, gjithsesi, sepse më pas do t'i shikojmë ato fotografi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

Py. Zoti dëshmitar, këtë ndërtesën që e shihni në fotografi përpara a e njihni?

Pë. Po. Po këtu është podrumi që kanë ndejtur të burgosurit dhe në katin naltë kanë ndejtur ushtarët. Nuk po di.

Py. Aty shohim tri ndërtesa.

Pë. Ato tjerat jo.

Py. A mundet -- një moment. Na tregoni, ju lutem, për të cilën ndërtesë e keni fjalën kur thoni "podrumi dhe kati sipër". Mund të thoni majtas ose djathtas.

Pë. [E padëgjueshme].

Py. Po me fjalë ama, ju lutem.

Pë. Me fjalë djathtas nga e nalta është. Ky është podrumi edhe në kati, nalt këtu kishin pasë ndejtë ushtarët. Podrumi stalla e lopëve ish kanë poshtë. Naltë janë që kanë ndejtë ushtarët.

Py. Në rregull. Te kjo ndërtesë shkuat? Tek kjo ndërtesë hytë?

Pë. Drejt. Drejt në këtë ndërtesë kemi shkuar kemi

kontrolluar podrumin kemi kontrolluar naltë. Tani kemi dalë para që saj ndërtese, nja dy qind metra, s'di sa i ka, i kemi gjetë një tub me dhé.

Py. Përpara se të arrijmë deri aty, pakëz më parë na treguat se ku ishin këto dokumentet. Thatë që gjetët dy dokumente. Çfarë ishin?

Pë. Po dokumente të *[REDAKTUAR]*. Njëna *[REDAKTUAR]* fletëlëshim i spitalit, se *[REDAKTUAR]* ka qenë i plagosun ka qenë në spital ma herët. E tash qysh i ka qëllu një fletë-lëshim në xhep, nuk e di. *[REDAKTUAR]* fletë-lëshimi i spitalit. Kam harru datat. Ai dokument, domethënë, *[REDAKTUAR]* qaty ka qenë.

Py. A e dini çfarë ndodhi me këto dokumente pastaj?

Pë. Unë sa e di, i ka marrë UNMIK-u ato dokumente, një fletë-lëshim dhe një regjistër të ushtarëve.

Py. Por përpara UNMIK-ut përpara se t'i merrte t'i pranonte UNMIK-u, ti vetë apo *[REDAKTUAR]* a i morët me vete këto dokumente?

Pë. Po. *[REDAKTUAR]* i ka marrë me vete.

Py. Në rregull. Pastaj thatë se pasi hytë brenda ndërtesës dolët nga ndërtesa për me kërku, për me lyp varrin. Ku e dinit ju se ku të kërkonit, ku ta lypnit varrin?

Pë. Ne nuk e dinim ku është, veç dolëm tash nga na e morr mendja se rreth burgut dikund, rreth shtabit mos dikund e kanë varros.

Py. A dinit që *[REDAKTUAR]* e dinte, pra, ti vetë e dinte *[REDAKTUAR]* apo i kishin tregu që varrin duhet ta lypte diku pranë burgut?

Pë. Ashtu i kishte tregu dikush që "*[REDAKTUAR]* nuk e ki të gjallë shko kërko rreth burgut dikund". Dhe q'ashtu shkuam na dhe dolëm edhe e gjetëm.

Py. E kuptoj. Është po i njëjti person ky, të cilin *[REDAKTUAR]* nuk donte me ta kallëzu se kush ishte?

Pë. Nuk e di kush është. Veç mu nuk më ka tregu kurrë pi kush. Nuk më ka tregu.

Py. Për ta gjetur varrin çka bëtë? Domethënë, si e lypët përreth burgut?

Pë. Po shkuam drejtë e kur e gjetëm tubën me dhé atëherë fillova unë vetë në anën, qysh po i bjen në anën e majtë, me shpu kur doli një batanija, një qebe. Edhe pak e shpumë doli fytyrë e panjofshme. Edhe fillum tash me shplu hala ama shumë kur doli edhe *[REDAKTUAR]* Ishin kanë bashkë të dytë në një varr.

Py. Disa pyetje para se të arrijmë tek varri. Bashkë me *[REDAKTUAR]* a e zbuluat bashkë --

Pë. Bashkë.

Py. -- a e gjetët bashkë--

Pë. Bashkë.

Py. -- këtë tubën me dhé?

Pë. Bashkë me *[REDAKTUAR]*

Py. Dhe me sa e dini ju ishte hera e parë që *[REDAKTUAR]* e pa apo e gjeti vendin ku pikërisht ishte varros *[REDAKTUAR]*?

Pë. Hera e parë.

Py. Dhe në lidhje me vendndodhjen e varrit, besoj na e thatë

që ishte rreth nja dy qind metra - po lexoj nga rreshti 7 i faqes 32 ku ju thatë që:

"shkuam nga kjo ndërtesa rreth nja 200 metra larg ndërtesës ku gjetëm këtë tubën me dhé".

Pra, ma merr mendja ishte afër me burgun; kështu?

Pë. Nuk po di tash sa metra me metër veç ta vina nja dy qind metra, s'di vallaj, përballë burgut.

Py. Po. Pra, nuk ishte fort larg, distancë e shkurtër?

Pë. Nuk a kanë larg, po s'di tash saktësisht nuk e di.

Py. Pa problem. në rregull.

Nga e kuptuat ju që ishte varr ai aty? Nga e kuptuat që ishte varr?

Pë. Na veç si e pamë dheun, dyshuam që është varr.

Py. Po sa i thellë ishte varri, domethënë, sa ju desh juve me rremi, me i zbulu trupat?

Pë. Jo, nuk ka qenë i thellë. Shumë pak dikun nja 30-40 centimetra. Hiç ma i thellë sa a kanë.

Py. Dhe thatë kur e shplutë dheun zbuluat fillimisht një trup tjetër. A e njoftët këtë trupin tjetër apo jo?

Pë. Jo. As sot nuk e di kush ka qenë hiç.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja Prokurore, po i afrohemi orës 11.00. A mund ta përfundoni këtë pjesë të pyetjeve hë për hë, për tani?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po edhe unë kështu mendoj se ky është momenti i duhur për të ndaluar sepse pastaj do të bëj

pyetje për të dy kufomat, kështu që nuk i mbuloj dot me katër minuta, nuk më dalin katër minuta për atë. Kështu që është momenti i duhur për pushimin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi rikthyer në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Zoti dëshmitar, tani do të bëjmë një pauzë 30 minuta, deri në orën 11.30. Do t'i kërkoj asistentes së sallës që t'ju shoqërojë për të dalë nga salla. Do të rishihemi përsëri pas një gjysëm ore.

DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta ndërpresim këtu seancën, do të rifillojmë mbas 30 minutash.

--- Pauza fillon në orën 10.57

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, të shohim kush është i pranishëm. Shohim që nga zyra e Prokurorisë kemi të njëjtët persona siç ishin paradite, apo jo?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, jemi

të njëjtët siç ishim në mëngjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E njëjta është e vërtetë edhe për Mbrojtjen, apo jo?

Po? Z. Von Bone?

Z. VON BONE: [Përkthim] Po, nuk kemi ndryshim.

Z. Von Bone, ndërkohë zoti Mustafa na dëgjon përmes videolidhjes.

Në rregull, atëherë, mund të vijojmë më tej.

Zonja Sekretare, ju lutem, a mund të shoqëroni dëshmitarin në sallën e gjyqit?

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti dëshmitar. Mirë se erdhët, zoti dëshmitar. Më dëgjon?

DËSHMITARI: Po, po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Tani do të t'ja jap përsëri fjalën zonjës Prokurore, në mënyrë që të mund të vijojë me pyetjet e saj.

Zonja Prokurore, ju lutem vijoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Py. Zoti dëshmitar, jemi në seancë të hapur dhe do t'ju bëj disa pyetje lidhur me çështjen që po diskutonim përpara pauzës.

Për informim të publikut, dua të them që ishim në pikën

kur ju po na përshkruanit që gjetët një varr dhe që patë dy trupa në të. Një trup e njohët, ndërkohë që trupin tjetër nuk e njohët. Do ju kërkoja të mos përmendnit emra, ndërkohë që tani do t'ju bëj disa pyetje në seancë të hapur, lidhur me këtë pikë.

Zoti dëshmitar, a mund të na tregoni hollësi që kanë të bëjnë me trupin e parë që zbuluat në varr, aty ku ju thatë që ju thatë që ishte trupi i dikujt tjetri që ju nuk e njohët.

Pë. Në trupin e parë veç e kemi zbuluar fytyrën dhe kemi vërejt që nuk është i panjofshëm, është -- dhe nuk e kemi prek, bashkëpunëtorë dhe e kemi mbuluar prapë. Kur kemi shku në tjetrën anë, kemi gjet një trup prej t'njoftun. I njoftun. Edhe atë si e kemi vëretu që është kurrkand, ne kemi kërku atëherë, kemi mbulu edhe atë prapë edhe kemi shku prej shpie.

Mbas dy ditësh, kemi shkue me traktor edhe kemi zbuluar, e kemi marrë edhe e kemi pru prej shpie. E këna varros --

Py. Më lejoni t'ju ndërpres këtu. Më duhet të kthehem pas dhe t'ju bëj disa pyetje shtesë që kanë të bëjnë me trupin e parë të cilin ju nuk e njohët.

A ju kujtohet ndonjë hollësi lidhur me trupin e këtij personi që nuk e njihnit, a ndonjë tipar i trupit, apo ndoshta rrobat, apo çfarë gjini kishte personi, a ju kujtohen këto?

Pë. Mashkull -- gjini mashkullore. Dhëmbët e parë i ka pasur të gjatë edhe si të zi, ashtu. Duket paska kanë duhanxhi, sigurisht. Tjetër kurrgjë s'e kena zbulu, për rroba, a për

diçka. Veç fytyrën i kemi zbuluar.
Py. A mund të na thoni në qoftë se ishte një person me moshë të re, mesatare apo i vjetër?
Pë. Mesatare, mesatare, diçka.
Py. Po lidhur me ngjyrën e flokëve apo fytyrën, a ka ndonjë hollësi tjetër që ju kujtohet?
Pë. Po, nuk muj me thonë veç u dojke me kanë si zeshkan po kish pas fillu me u prish, u dojke me kanë si zeshkan, si e do fytyrën e gjatë.
Py. Në rregull, a mund të na tregoni se çfarë bëtë pasi gjetët këta dy trupa? Dhe pasi i zbuluat ata pak, pra ju thatë që njërin e njohët, tjetrin nuk e njohët. Çfarë bëtë më pas dhe ju lutem mos harroni që nuk duhet të përmendni emra.
Pë. Më pas veç i mbulum prapë, i lamë qe ashtu, dhe erdhëm te shtëpia.
Py. Pra nuk i lëvizët ose nuk i hoqët trupat nga aty?
Pë. Jo, nuk --
Py. Si e latë varrin. Në çfarë kushtesh e latë varrin para së të largoheshit?
Pë. Si e kena gjet, q'ashtu edhe e lamë.
Py. Në rregull. Ju na thatë se më vonë shkuat përsëri në të njëjtin vend. A është e saktë kjo?
Pë. Po, shumë e saktë.
Py. A ju kujtohet se sa kohë kaloi që nga hera e parë që kishit shkuar te varri, kur u thyet për së dyti?

sa kohë kishte kaluar?
Pë. Mbas dy ditësh, a tre -- dy. S'po di saktë, por tre ditë.
Py. Në rregull. Më vonë do t'ju pyes ndërkohë që të jemi në seancë private, lidhur me hollësi të tjera. Për shembull, me kë shkuat atje. Kështu që të lutem për momentin mos ju përgjigj kësaj pyetjeje.
Por, a mund të na thoni se çfarë bëtë herën e dytë kur shkuat, kur u kthyet për së dyti te varri. Çfarë bëtë pra në vija të përgjithshme dhe të lutem, sërish, mos përmend emra.
Pë. Herën e dytë, kur kemi shkuar, e kemi zhvarros trupin edhe e kemi qit në traktor, e kemi pru për shtëpi.
Py. Çfarë ndodhi me trupin tjetër që ndodhej në të njëjtin varr?
Pë. Trupin e tjetër veç e kemi mbuluar me dhe, dhe qe aty ka mbete.
Py. Pra e kuptoj që ju nuk e lëvizët trupin tjetër vetëm thjeshtë e mbuluat me dhe e latë aty ku ishte. E Saktë kjo?
Pë. Saktë, shumë është.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e në qoftë se mund të kalojë në seancë private që kanë të bëjnë me disa pyetje është do të nxjerrin informacione identifikues.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja Sekretare, ju lutem, a mund të na kaloni në seancë private?

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, sekretare.

Zonja Prokurore, ju lutem vazhdoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Py. Zoti dëshmitar, tani jemi në seancë private dhe do t'ju pyes për emrat e personave me të cilët ju shkuat në varrin e *[REDAKTUAR]* herën e dytë, pra herën që ju thatë që keni shkuar me traktor. A mund të na thoni ju lutem se me kë shkuat atëherë?

Pë. Atëherë ka qenë *[REDAKTUAR]*. Krejt *[REDAKTUAR]* [e pakuptueshme]. Ka qenë -- ka qenë -- ka qenë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*. Kush ka qenë edhe tjetër -- sa u bënë -- gjashtë -- pesë a gjashtë.

Py. Ndonjë nga *[REDAKTUAR]*, a ishte i pranishëm atje bashkë me ju të tjerët?

Pë. Po harroj, s'e di. A kanë *[REDAKTUAR]* [e pakuptueshme] -- *[REDAKTUAR]* S'po më kujtohet, vallahi.

Py. Nuk ka problem. Ju na keni thënë gjatë intervistës dhënë për Zyrën e Prokurorisë së Specializuar se *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* ishte i pranishëm atje.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për procesverbal, është në faqen 17.

Atëherë do jap referencën për procesverbalin dhe pastaj

do të vazhdojmë me pyetjet.

Të nderuar Gjykatës, është faqja 17, rreshtat nga 6 deri në 12, Pjesa 2 e transkriptimit me numër identifikimi 076509-TR-ET, RED1. Citimi ekzakt është te pyetja:

"Po *[REDAKTUAR]*?" – është pyetja.

Dhe përgjigja është:

"Po, *[REDAKTUAR]* që është *[REDAKTUAR]*".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

Py. A ka bërë njeri fotografi të vendit të varrimit dhe të procesit të zhvarrimit?

Pë. Po, po.

Py. A e mbani mend se kush i ka bërë fotografitë?

Pë. Është *[REDAKTUAR]*

Py. Pra, ju thatë që herën e dytë sërish ju e zbuluat trupin, e morët trupin e *[REDAKTUAR]* e morët me vete. A e mbani mend se çfarë keni bërë ju vetë, personalisht, domethënë çfarë keni bërë gjatë herës të dytë, pra gjatë zhvarrimit të trupit të *[REDAKTUAR]*. Çfarë ke bërë ti vetë personalisht atëherë, a të kujtohet?

Pë. Më kujtohesh shumë mirë se atë s'kam qenë mirë hiç unë. Kam qenë shumë i emocionuar. As më kanë lënë me u afru, bile -- shumë keq e kam ndier veten atë ditë. Shumë mirë më kujtohet.

Py. A e patë nga afër trupin e *[REDAKTUAR]* këtë herën e dytë që shkuat apo jo?

Pë. Jo, isha afër përveç sa dikun pesë-gjashtë metrave. Kam pas -- nuk më lanë me u afru. S'më kanë lënë hiç. Hiç. Se s'jam ndier mirë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Përsëri, të nderuar Gjykatës, nuk e di në qoftë se do të më lejoni që të citoj një pjesë të mëparshme të deklaratës që u dha për ZPS-në.

Py. Ju i keni thënë ZPS-së, dhe flas posaçërisht për transkriptimin, faqja 1, dokumenti 076509, faqe 18, rreshti nga 7 deri në 9. Ti ke thënë:

"*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

A e mban mënd këtë gjë, dhe a është e vërtetë kjo gjë?

Pë. Në fillim kam filluar unë me gërmu ma shumë dhe mirëpo dikun s'jam ndier mirë dhe më kanë largu. S'më kanë lanë ma aty. Se unë e kam fillu në fillim vetë më së pari, dhe vetë e kam zbulu më së pari.

Py. E kuptoj, faleminderit që na e sqaruat.

Ju thatë se kur shkuat *[REDAKTUAR]* për herë të parë te vendi i varrimit, mundët që të identifikonit edhe ju trupin e *[REDAKTUAR]* A është e saktë kjo?

Pë. Shumë e saktë.

Py. A mund të na tregoni, se e mbaj mend që përshkruat disa tipare fizike. A mund të na tregoni se çfarë tiparesh fizike

ose çfarë gjërash kishte veshur personi që ju bëri ju që të mendoni që ai ishte *[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* dhe

aty e kam pae. Është e sigurt [e pakuptueshme] edhe trup i dilke *[REDAKTUAR]*, që ashtu në që atë *[REDAKTUAR]* e kam pa.

Py. Tani, zoti dëshmitar, do ju kërkoj që të shikoni një grup fotografish që ju janë treguar më parë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund t'i tregoj Sekretares që të shikojë në qoftë se fotot i ka përpara dëshmitari apo jo? I ka.

Py. Atëherë, zoti dëshmitar, keni një dosje të vogël aty përpara. Ju lutem, a mund ta shikoni atë ndërkohë që unë kërkoj sekretaren që të na shfaqë dokumentet në ekran?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do t'i kërkoja sekretares që të na shfaqë dokumentin me numër reference ERN SPOE 00209313 deri në SPOE0029320. Është nën-ndarja 9 e listës së materialeve për këtë dëshmitar.

Do ju kërkoja të shfaqnit faqen 1 në ekran.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për procesverbal, Gjykatësit e kanë parë dosjen që i është dhënë dëshmitarit.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Py. Zoti dëshmitar, a ju kujtohen këto fotografi? Ju lutem shihini pak këto fotografi dhe na thoni a ju kujtohen këto fotografi?

Pë. Fotografitë, po. Po më kujtohen, edhe ky vendi, dhe ky dhé po më kujtohet mirë.

Py. E kuptoj që ju po komentoni për fotografinë e parë të grupit të fotografive që kemi përpara në ekran, që është fotografia me numër reference SPOE0029313.

Çfarë të kujtohet nga kjo fotografi?

Pë. Nuk po jam i sigurt a është ky dhe që e kemi gjet para se me e nxjerr kufomën, a mbasi e kena nxjerrë. Këtë -- s'po jam i sigurt. Se ka pas dhe shumë atëherë.

Py. Çfarë vendi të kujtohet nga kjo fotografi? Domethënë, çfarë vendi ishte ose çfarë dheu ishte?

Pë. Dhe normal, vendi ka qenë rreth me mal. Veç një fushë e vogël. Q'aty është.

Py. Dhe ky është vendi ku ishte varrosur trupi i *[REDAKTUAR]* A është e saktë kjo?

Pë. E saktë është. Po s'po di a kena nxjerrë qetu, te kjo foto, a asht *[REDAKTUAR]* këtu, a është kur e kena hjek.

Py. Në rregull.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të na shfaqni faqen 3 ju lutem, dokumentin me numër reference SPOE002895.

Py. Zoti dëshmitar, ju lutem a mund ta shihni këtë foto e të na thoni në qoftë se ju kujtohet gjë lidhur me të.

Pë. Sipas fotografisë këtu, e kemi hjek *[REDAKTUAR]* Veç pjesët të qebes janë mbetur.

Py. Në rregull.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të kalojmë te faqja tjetër ju lutem, SPOE00209316. Mbase mund ta kthejmë në drejtimin e kundërt të akrepave të orës. Në rregull.

Py. Zoti dëshmitar, a e njihni këtë fotografi? E keni parë më përpara?

Pë. Shumë i sigurt jam që është *[REDAKTUAR]*, fotografia *[REDAKTUAR]*Prej trupit, *[REDAKTUAR]* krejt edhe në njërën anë ka qenë *[REDAKTUAR]*, në tjetrën anë është tjetri.

Py. Në rregull. Ju na thatë se e hoqët trupin *[REDAKTUAR]* se nuk e cekët trupin e dytë dhe që e mbuluat përsëri varrin me dhé. Është e saktë kjo?

Pë. E saktë. Ne e kemi shtënë prapë atë tjetrin, e kena mbulu mos me u duk.

Py. Me sa dini ju, a u informua ndonjë person që trupi i *[REDAKTUAR]* u gjet në atë vendin aty dhe që u gjet së bashku me të edhe një trup i dytë?

Pë. Veç UNMIK-un e kemi njoftu, tjetër kënd s'kemi pas kah.

Py. Në rregull.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për arsye të organizimit të brendshëm, kam edhe pak pyetje për të bërë. Domethënë, jam gati për të përfunduar marrjen në pyetje nga pala thirrëse, nga Prokuroria.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

Py. Zoti dëshmitar, jemi drejt fundit të marrjes tuaj në pyetje. Pasi u zhvarros trupi, ku e dërguat trupin e *[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]* ne e kemi zhvarros këtu dhe e kemi varros *[REDAKTUAR]*

Py. Zoti dëshmitar, tani do t'ju tregoj një dokument që e keni përmendur gjatë dëshmisë tuaj sot dhe që e keni parë më përpara dhe do t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë dokument.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të kërkoj të shfaqet dokumenti që jepet në ndarjen 7 të listës materiale për këtë dëshmitar. Është dokumenti me numër reference 076276 deri në 076281 dhe dua që të më shfaqet kjo faqe, ju lutem.

Py. Zoti dëshmitar, a mund ta shihni dokumentin që u shfaq tani në ekran dhe të na thoni në qoftë se e keni parë këtë dokument, në qoftë se e dini se çfarë është ai?

Pë. Po, po. Më kujtohet mirë. Është fletë-lëshimi *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* një herë, nuk po di unë – po harroj [e pakuptueshme].

Py. Ça do të thuash me "ai" që *[REDAKTUAR]* që po thoni?

Pë. *[REDAKTUAR]* qe ky fletë-lëshim kur është, i ka qëlluar në xhep, q'ashtu.

Py. A është ky dokumenti që gjetët ju, *[REDAKTUAR]*, në

ndërtesën që ishte afër varrit, dokumentin të cilin na e përmende më parë?

Pë. Po, që ky është. Dokumenti është në tjetër -- është me emrat e ushtarëve. Kaq qysh kanë dhanë rojet, ushtarët andej, s'di, me rreshta është e ndamë.

Py. sapo thatë në rreshtin 1 dhe 2, faqja 45 e transkriptimit në kohë reale. Thatë që : "...letra u gjet me të, në xhepin e vet".

Çfarë do të thuash me këtë?

Pë. Jo, jo. E kemi gjet nalt, në katin e dytë mbi podrum në atë pjesë. Në dollap e kemi gjetur. I ka qëllu *[REDAKTUAR]* në xhep dhe e kanë -- se s'i ka vy kurrgjë atyre. Një dokument --

Py. Po nga e dini këtë gjë, nga e dini që *[REDAKTUAR]* e kishte në xhep këtë letër?

Pë. Po them që ka qëllu në xhep se s'po e di. Sigurisht e ka pas në xhep, a dikun. Se ky dokumenti është i 1990, po rastësisht i ka qëlluar në xhep.

Py. Atëherë ta sqarojmë pak, ta shohim në qoftë se mund ta sqarojmë. Pra ti po thua që ti besoje që ndoshta këtë dokumentin e ka pas me vete, këtë po thua? Në momentin që është arrestuar?

Pë. Kështu që është.

Py. Pra kjo është diçka që ti beson se ka ndodhur? Me fjalë të tjera, e di me siguri që *[REDAKTUAR]* e kishte në xhep këtë dokumentin apo thjesht kështu mendon se i ka qëlluar?

Pë. Ndaj unë se s'ka pas tjetër dokument [e pakuptueshme].
Veç ato ka mbajtur në xhep, po nuk po e di pse.
Pë. Në rregull, por në çdo rast, ky është dokumenti që ju e gjetët, domethënë *[REDAKTUAR]* e gjetët bashkë në ndërtesën në katin e dytë.
Pë. Po, në dollap, q'ashtu.
Py. Në rregull. A mund të na përshkruani se për çfarë fliste ky dokument? Ti the që *[REDAKTUAR]*. A e di se çfarë i kishte ndodhur atij kur *[REDAKTUAR]*
Pë. *[REDAKTUAR]* nëpër Prishtinë, e kjo po më duket *[REDAKTUAR]*, në vitin 1990. *[REDAKTUAR]*
Py. A e dini ju se pse *[REDAKTUAR]* ai? Ose *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Pë. *[REDAKTUAR]* tuj dalë për me marrë pjesë gjithkund.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Përsëri do ju kërkoja, të nderuar Gjykatës, në qoftë se mund ta rikujtoj dëshmitarin duke i lexuar atë çfarë i ka thënë intervistës së UNMIK-ut.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem vazhdoni, zonja Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]
Py. Zoti dëshmitar, do të lexoj nga deklarata që i keni dhënë UNMIK-ut *[REDAKTUAR]*. Numri ERN është SPOE012889 deri në 00128201 dhe do të lexoj nga faqja 8 e dëshmisë suaj.

Përgjigja juaj ishte si më poshtë: "Po" --

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faqja 8. Është paragrafi i fundit i deklaratës në këtë faqe.

Py. Do ta lexoj përgjigjen që keni dhënë ju:

"Po, letrat që më treguat janë dokumentet që unë dhe *[REDAKTUAR]* i gjetëm në qendrën e ndalimit në vitin 1999", gjë të cilën edhe na shpjeguat sot këtu.

Do vazhdoj më tej me leximin e deklaratës.

"Dokumentet për daljen nga spitali, që kanë emrin e *[REDAKTUAR]*, kishin të bënin *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Këto *[REDAKTUAR]* organizoheshin çdo ditë
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

A mbani mend se e keni thënë këtë gjë dhe a është e saktë kjo gjë?

Pë. Po, shumë e saktë.

Py. Në rregull.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të rikthehemi në seancë publike, në mënyrë që unë ta mbyll marrjen në pyetje të dëshmitarit nga ana jonë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja

Sekretare, të kalojmë në seancë publike, ju lutem.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi rikthyer në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zonja Sekretare.

Zonja Prokurore, fjala është për ju.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Py. Zoti dëshmitar, unë kaq pyetje kisha nga ana ime. Faleminderit shumë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam pyetje të tjera për këtë dëshmitar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

Atëherë, Mbrojtësja e Viktimave -- do ta them ndryshe: keni pyetje për këtë dëshmitar?

ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë keni fjalën për pyetjet që do t'ja bëni. Mund të vazhdoni.

Zoti dëshmitar, tani Mbrojtësja e Viktimave është ajo e cila do t'ju bëjë disa pyetje.

ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Mendoj se të gjitha pyetjet tona kanë të bëjnë me

personin e dëshmitarit apo familjen e tij kështu kërkoj që të kalojnë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. Zonja sekretare, të kalojmë në seancë private, ju lutem.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zonja sekretare.

Zonja Mbrojtëse e Viktimave, keni fjalën.

ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Zoti dëshmitar, kam disa pyetje për ju të cilat kanë të bëjnë me ndikimin personal që ka pasur te ju fati *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

A mund të na shpjegoni fillimisht *[REDAKTUAR]* në të cilën ndodheshit ju vetë në vitin 1999? E kam fjalën për *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* apo jo?
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Tash çka t'them.

Py. Faleminderit. Na përshkruat sot paradite se si u ndjeve vetë kur e zbuluat varrin e përkohshëm të *[REDAKTUAR]*, siç

mund ta quaj. Dhe i thatë Prokurores se u ndjetë shumë keq se e donit shumë *[REDAKTUAR]*

Dhe pastaj më pas, thatë kur e zbuluat herën e dytë trupin e *[REDAKTUAR]* u ndjetë shumë keq. A mund të na e tregoni edhe një herë se çfarë ndjetë, çfarë menduat, çfarë përjetuat, ç'emocione kishit. Më me hollësi, që të na përshkruani më saktë se çfarë doni të thoni me fjalët "u ndjeva keq".

Pë. Është e vështirë me e përshkru sa keq jam ndjerë atë ditë se kish pas fillu me ardh edhe era dhe tash unë veç ma s'parit -- dhe tani më nxuni ajo era dhe jam ndier shumë keq. Dhe s'më ka kanë lënë më me u afru, më kanë thënë "largohu, largohu".

Py. E kuptoj, pra fizikisht përvoja që patët kur filluat ta zbulonit ishte që u ndjetë keq sepse *[REDAKTUAR]*. A mund të na e shpjegoni diçka më shumë, këtë emocion?

E di, që është e vështirë. E di që është e vështirë të na e tregoni por mendoj se është e rëndësishme që ne si juristë, avokatë këtu ta kuptojmë më me hollësi se si ndiheshin ata që ishin të pranishëm aty, për këtë *[REDAKTUAR]*

Pë. Unë nuk po di qysh po ta përshkruaj. Se aty ishim shumë i prekur, shumë keq dhe sot e kësaj dite kufoma nuk guxoj më e pa, me shku më afër. Më ka mbetur ajo në kry. Nuk muj me pa kufoma. Dhe më kanë, më kanë larguar mua dhe më s'kam pas kontakt aty.

Py. Këto fotografitë e kufomës së *[REDAKTUAR]* që sapo jua treguan, kur jua treguan, çfarë ndieve ti kur i pe. Tani, edhe

njëherë këto fotografi?
Pë. M'u kujtua sikur në atë kohë. Shumë keq.
Py. Për këtë e kisha fjalën, do të doja të dija se si u ndjeve ti në ato çaste kur ja pe kufomën *[REDAKTUAR]* në vitin 1999. A mund të na tregoni paksa, se si kjo përvojë, se si kjo përballje të ka ndikuar te ty më pas në jetë. Çfarë ndikimi ka pasur, a mund të na japësh diçka më shumë informacion për këtë?
Pë. Unë ma keq se atë ditë s'jam ni kurrë në jetë, në jetën time s'jam ndier kurrë më keq se atë ditë kur e pashë. Era e keqe -- fytyra ish prish, kishte fillu me ardh erë dhe më dashtë me u gjet në një gjendje shumë rëndë. Dhe prej atë ditë mo, as ku ka kufoma nuk guxoj me hy. Më ka met, q'ashtu.
Py. A të ka ndryshuar jeta pas kësaj? Gjithmonë jeta kujtdo i ndryshon, gjithmonë ndryshon, por a sheh ndonjë lidhje midis ndryshimeve në jetë dhe asaj që ke parë atë ditë?
Pë. Po vallahi shoh shumë ndryshime. Se jam prej atëherë jam metë me pasoja, nervoz, me pagjumësi, me shumë sende më ndikojnë këto. Prej atëherë.
Py. Po këto gjërat e tjera çfarë janë, pagjumësi mbase?
Pë. Pagjumësi, po do ëndrra do sende, nganjëherë bile shumë -- nganjëherë edhe nervoz tani. Tana u banë.
Py. Keni marrë, merr ndonjë bar, medikament për ta zgjidhur?
Pë. Po, *[REDAKTUAR]*, vallahi.
Py. Zoti dëshmitar, ti vetë a ke familje? A je i martuar? Ke

fëmije?
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. Në rregull. Faleminderit, zotëri. A dëshiron të na thuash diçka tjetër sa i takon ndikimit që ka pasur, emocionet që ke pasur në lidhje me atë çka i ka ndodhur *[REDAKTUAR]* Se kjo është pyetja ime e fundit. Nëse ka diçka tjetër që po dëshiron të na e thuash, ky është rasti.
Pë. Nuk di ç'ka të them më shumë, veç kurrë në jetë më keq s'jam ndier. Prej atëherit -- jam ndier shumë keq edhe kam pas probleme më shumë. Qe tash i kam përdor do barna, jam pak më mirë, se s'jam kanë hiç mirë. S'mujsha me flejtë, pajsha ëndrra, u frigojsha. Tashti jam pak më mirë. Qe kështu barna kam lloje lloje. Nuk di çka të them tjetër.
Py. Në rregull. Faleminderit, po e lëmë me kaq.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja Sekretare, të kalojmë në seancë publike ju lutem.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zonja sekretare.

Ka përfunduar bërja e pyetjeve të dëshmitarit 4674 nga Mbrojtësja e Viktimave dhe nga ZPS-ja. Tani e ka radhën Avokati i Mbrojtjes.

Zoti Avokat, jeni i gatshëm të filloni me kundër pyetjet menjëherë tani?

Z. VON BONE: [Përkthim] Do të parapëlqenim që të bënim një pauzë, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull atëherë, do veprojmë kështu. Është ora 12.15. tani po bëjmë pushimin për të gjithë ne, që do të thotë se do të rifillojmë pas një ore e gjysmë me kundër pyetjet që do të bëjë Mbrojtja.

Zonja asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin të dalë nga salla.

Zoti dëshmitar, tani do të bëjmë pauzë një orë e gjysmë. T'ju bëjë mirë dreka, do të ri shihemi pas -- atëherë.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Në rregull, do të ndërpresim këtu seancën. Do të rifillojmë në orën 13.45.

--- Pushimi i drekës filloi në orën 12.16

--- Seanca rifillon në orën 13.45

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të shikoj ekipet nëse janë të njëjtat. Prokuroria?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk ka asnjë ndryshim e nderuara Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk ka ndryshim për Mbrojtësen e Viktimave.

ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] E njëjta përbërje.

Z. VON BONE: [Përkthim] E njëjta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti Mustafa vazhdon të na ndjekë përmes video lidhjes. Shumë mirë atëherë.

Zonja asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin të hyjë në sallë.

Sa i takon planit sot, kemi një seancë 1 orë e gjysmë tani, 90 minuta dhe vetëm kaq do të jetë për sot. Pastaj do të rifillojmë nesër paradite në orën 9.30.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u rikthyet zoti dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t'ia jap fjalën tani Avokatit të Mbrojtjes të fillojë me kundra pyetjet e tij.

Keni fjalën zoti avokat.

Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë e nderuar Gjykatëse.

Pyetje të palës tjetër nga z. von Bone:

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Mirëdita zoti dëshmitar.

Pë. Mirëdita.

Z. VON BONE: [Përkthim] Do të kërkoj të kaloj në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

Z. VON BONE: [Përkthim] Ata që na ndjekin ta kuptojnë që do zgjasë seanca private. Thjeshtë për ta ditur njerëzit.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Avokat, fjala është për ju.

Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Zoti dëshmitar, si ta quajnë babanë të lutem?

Pë. Babën tim?
Py. [pa përkthim].
Pë. *[REDAKTUAR]*
Py. Faleminderit shumë. Zoti dëshmitar, e keni dëgjuar ndonjëherë *[REDAKTUAR]*
Pë. Jo.
Py. Emrin *[REDAKTUAR]*, e keni dëgjuar ndonjëherë?
Pë. Kurrë.
Py. Emrin Rrahim Gashi, e keni dëgjuar ndonjëherë?
Pë. Jo, jo. Nuk më kujtohet, kurrë.
Py. Dhe e fundit, emrin *[REDAKTUAR]*, a e keni dëgjuar ndonjëherë?
Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. E dini ku ndodhej ky person gjatë luftës?
Pë. Nuk e di.
Py. Me këtë *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. Ke pasur ndonjë kontakt me të gjatë luftës?
Pë. Jo.
Py. Është gjallë ende ky person?
Pë. Po.
Py. Zoti dëshmitar, t'i kthehemi tani momentit kur keni shkuar nga *[REDAKTUAR]*, jeni kthyer *[REDAKTUAR]*. Në veçanti personat *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*. Për këtë.
Pë. Po, *[REDAKTUAR]*
Py. Kur thua *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Pë. *[REDAKTUAR]*
Py. Nuk jeni i sigurt a ishin pesë, a gjashtë njerëz që erdhën.
Pë. Nuk jam i sigurt, a pesë, a gjashtë, a shtatë. Vallahi e kam harru.
Py. A bisedove ti vetë personalisht me ndonjë prej këtyre personave?
Pë. Po veç një e kam njoft atje, s'i kam njoft asnjë. Atë *[REDAKTUAR]* me pseudonimin *[REDAKTUAR]*. Atë e kam njoft.
Py. Po, e kuptoj. Por pyetja ime është kjo, a fole me ndonjë prej tyre, pavarësisht a i njihje apo jo?

Pë. Tybe jo shumë s'kam fol se nuk dojshin ata me tregu kurrgjë. Prenë thonjtë, e hëngrën bukë, e u rrojtën dikush e shkun. Prandaj s'kam pas kohë me u marrë me to.

Py. Ku ndodhi kjo me saktësi në *[REDAKTUAR]*?

Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* kanë ndejt, deri në mbrëmje. Në mbrëmje kanë ik në Prishtinë.

Py. Pra, ky takim që edhe u takuat edhe hëngrën ata, *[REDAKTUAR]* ka ndodhur, *[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. Ti vetë, ke qëndruar gjatë gjithë kohës aty, që nga fillimi deri në momentin që u larguan ata?

Pë. Po.

Py. Po ndonjë prej, më fal. Ta them ndryshe.
Në përfundim të këtij takimi si me thënë apo drekë-darkë, mbasi u pastruan gjëra, u larguan të gjithë apo mbeti dikush?

Pë. Jo, një ka mbet. Ka ardh me neve deri në Prishtinë. Ai *[REDAKTUAR]*, ai ka ardh deri në Prishtinë. Ka bujt një natë me neve dhe ka ec, s'di kah ka shku.

Py. A e njihnit ju kush ishte *[REDAKTUAR]* A u shpjegu ai vetë kush ishte?

Pë. Ai ishte, s'di qysh me e thanë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* dikun. Kam harru cilit vend.

Py. A e pe ti vetë të nesërmen që u largua ai?

Pë. Po. Po, po. Bashkë kemi shku deri në Prishtinë. Një natë ka flejt me neve dhe te nesërmen ka ik. Nga ka shku, s'di. As kam nij për të kurrë kurrgjë.

Py. Dhe kur thua me neve, më fal që e bëj këtë pyetje, e ke fjalën me ty vetë apo *[REDAKTUAR]*. Ka *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* apo *[REDAKTUAR]*?

Pë. Kemi ik ne në Prishtinë bashkë, të tërë. Në Prishtinë, *[REDAKTUAR]* ai një natë me neve edhe të nesërmen ka ik.

Py. A ju kujtohet emri i *[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]* Po. *[REDAKTUAR]*

Py. Kur po hanin këta, more pjesë dhe ti në drekë së bashku me këta personat që kishin qenë të ndalum?

Pë. Jo.

Py. A pati ndonjë moment tjetër kur ti vetë fole me njërin prej tyre? Që bisedove, fole se çfarë u kishte ndodhur.

Pë. Vallahi, ne kemi dalë me prit që po vjen *[REDAKTUAR]* rrugës, unë e *[REDAKTUAR]* ma shumë kemi ndejt në rrugë duke prit kolonën. Ka qenë kolonë e gjatë e popullatës. Ne kemi dalë me prit, ku po e gjejmë *[REDAKTUAR]*

Py. Kush ju dha informacion se do të vinte *[REDAKTUAR]*

Pë. Ai, *[REDAKTUAR]* tha, "Neve na lirun. Edhe *[REDAKTUAR]* e lirojnë tash, e lirojnë, vjen". Tha, "*[REDAKTUAR]* edhe një *[REDAKTUAR]* kanë mbetur atje".

Py. A folët për gjë tjetër me këtë *[REDAKTUAR]*?

Pë. Jo, kurrgjë tjetër, hiç.

Py. A foli ai, tha ndonjë gjë lidhur me kushtet në të cilat i kishin mbajtur ata?

Pë. Besa, jo, s'ka fol me mua, por ka fol me dikë tjetër aty dhe ka thënë, "Mos i tregoni këtyre se *[REDAKTUAR]* e kanë mundu shumë". Ne ma vonë e kemi marrë vesh.

Py. Këtë juve jua tha *[REDAKTUAR]* kështu është?

Pë. *[REDAKTUAR]* jo mua. Ia ka thanë një *[REDAKTUAR]* dikujt. "*[REDAKTUAR]* edhe ato i kanë mundu shumë edhe kanë mbet në burg. Veç po i lirojnë edhe ata". Ata s'u liruan kurrë.

Py. Kujt *[REDAKTUAR]* ia tha këtë gjë ai?

Pë. *[REDAKTUAR]*

Py. Ti personalisht ishe aty i pranishëm, apo ta tha *[REDAKTUAR]* më vonë këtë gjë?

Pë. Ma vonë mua ma ka thanë. Se atë ditë s --. Ka qenë kohë e keqe, kohë lufte. Veç ma vonë ma ka thanë që, "Më ka tregu *[REDAKTUAR]* që, *[REDAKTUAR]* edhe një të *[REDAKTUAR]* i kanë mundu shumë, i kanë keqtrajtu në burg".

Py. Ndonjë nga grupi i personave që erdhën tek oborri i shtëpisë së *[REDAKTUAR]*, ndonjëri prej tyre a foli me ty personalisht apo të tha ty personalisht vetë se çfarë i kishte ndodhur atij dhe në çfarë kushtesh ishte *[REDAKTUAR]*

Pë. Jo. Nuk dojshin ata me fol shumë. Kishin frikë a nuk e di unë.

Py. A vure re ndonjë gjë të veçantë konkrete në sjelljen e

tyre, ti vetë?
Pë. S'më kujtohet kush, të veçantë.
Py. Ndonjëri prej tyre, a kishte nevojë për kujdes mjekësor?
Pë. Hiç s'më kujtohet.
Py. Ndonjëri prej këtij grupi, a u ankua për dëmtime që kishin pësuar?
Pë. Nuk më kujtohet kurrgjë. Nuk e di.
Py. Ju e njihnit *[REDAKTUAR]* si anëtar të familjes?
Pë. Po.
Py. A e dinit ju... Ta formuloj ndryshe. *[REDAKTUAR]*, gjithmonë ka jetuar në Kosovë?
Pë. Gjithmonë.
Py. A ka qëndruar ai gjatë të gjithë kohës *[REDAKTUAR]*?
Pë. Po, gjatë gjithë kohës *[REDAKTUAR]*. Ndonjëherë ka banuar edhe nëpër Prishtinë. Ka pas dal për shëtitje, ka pas do shoqni, por me banesë të përhershme *[REDAKTUAR]*.
Py. Çfarë profesioni kishte ai?
Pë. *[REDAKTUAR]* Profesionin kurrfarë. Me u rreh me njerëzit. Do shokë ka pas, ai *[REDAKTUAR]* ka qenë hajn i keq. Shokë të këqij ka pas. A si njeri, ka qenë djalë i mirë.
Py. Po familje, a kishte ai?
Pë. Po mor. *[REDAKTUAR]* jo. Jo, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* hiç.
Py. A kishte ndonjë partnere që e dini ju?
Pë. *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Py. A e kuptoj drejtë që, ju nuk e dini në qoftë se ai kishte partnere apo jo? Këtë po thua?

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. A e ke diskutuar ti ndonjëherë këtë gjë me të?

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Pë. Dikush kam ndij tash veç sipas të dëgjumeve atje në shtab ata që e kanë dhunu e kanë keq --, kanë ushtru dhunë kundër tij, kanë thanë është *[REDAKTUAR]*. Kam ndij, sa e vërtetë ashtë s'e di.
Py. Kjo ka qenë përpara luftës?
Pë. Kur ka qenë i arrestuar *[REDAKTUAR]* e kam ndij që kanë thanë, ky ashtë *[REDAKTUAR]* Për këtë e kanë arrestu. Ia kanë pas inatin njerëzit se ka rreh njerëzit fort shumë edhe njerëzit e rrehën.
Py. A mund të na thoni se nga kush e ke dëgjuar këtë gjënë që, ai mund të ishte *[REDAKTUAR]* Kush jua ka thënë këtë gjë?
Pë. E kam nij prej, nuk e di se kush ka thanë. Veç kam dëgjuar fjalë që e kanë shpall *[REDAKTUAR]* kanë ushtruar dhunë ndaj tij vetëm se ashtë *[REDAKTUAR]* Kush e ka thanë, s'di. Kështu çka u fol nëpër popull.
Py. Pra, ju as nuk e dini në qoftë se njerëzit që e kanë thënë këtë gjë, në fakt e dinin për vete këtë gjë, apo jo?
Pë. Dikush e ka fol atë fjalë. E kam ndij shumë herë e nuk di kush. Gjoja se për atë u burgos ai.
Py. Gjatë kohës së luftës, a ke dëgjuar ndonjëherë për arrestime të tjera që kanë ndodhur *[REDAKTUAR]* apo rreth

Llakuarës?

Pë. Jo, i vetmi arrestim është.

Py. A e dini ju se kush e arrestoi atë?

Pë. Po. Po, e di.

Py. A mund të na e thuash, të lutem?

Pë. Veç një moment. *[REDAKTUAR]*

Py. Kush ishte ky?

Pë. *[REDAKTUAR]* në emër të ushtrisë. Polic ushtarak u prezantu, me dy djem të rinj ka qenë edhe i kanë thanë *[REDAKTUAR]* e kemi urdhrin me të arrestu. *[REDAKTUAR]* menjëherë ka hy në makinë, s'ka bo problem kurrgjë.

Py. Këtë e ke dëgjuar vetë nga *[REDAKTUAR]*

Pë. Jo nga *[REDAKTUAR]* Por e di që *[REDAKTUAR]* se kanë qenë aty prezent s'di sa njerëz kur e kanë arrestuar. Edhe kam fol unë me *[REDAKTUAR]* ma vonë, e kam pyet "Ku ashtë *[REDAKTUAR]*? Më ka thanë, "E kanë çuar në zonë të *[REDAKTUAR]*". *[REDAKTUAR]* s'e kishin çu kurrkund, po *[REDAKTUAR]* q'aty.

Py. A ju kujtohet se kur ka qenë që keni folur me *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* rreth kësaj gjëje?

Pë. Gjatë bombardimeve. Nuk di çfarë date, çfarë dite. Kam qenë në katund, se një ditë prej Prishtine dolëm në katund, e kur kthehemi në mbrëmje, jam taku *[REDAKTUAR]*. Edhe rrugës tuj ec për Prishtinë, e kam vet "*[REDAKTUAR]* tregomë ku ashtë *[REDAKTUAR]* Më ka thanë, *[REDAKTUAR]* e kanë çu në zonën e *[REDAKTUAR]* kish qenë në Zllash.

Py. A ju tregoi ju ai që, ishte vetë ai personi që e dërgoi *[REDAKTUAR]* atje?

Pë. Po, po, po. Vetë e ka arrestuar, ai me dy djem të rinj. Bashkë kanë qenë tre vetë.

Py. Pyetja ime është kjo, këtë ta tha vetë ai personalisht ty?

Pë. Personalisht më ka thanë, *[REDAKTUAR]* e kanë çu në zonë të *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* ishte personi që e dërgoi atë atje?

*[REDAKTUAR]* Po, *[REDAKTUAR]*

Py. A ta tha *[REDAKTUAR]* vetë ty këtë gjë?

Pë. Ne krejt e kemi dit që *[REDAKTUAR]* edhe dy djem e kanë arrestuar. Për këtë edhe e pyeta *[REDAKTUAR]* tregomë ku ashtë *[REDAKTUAR]* Tha, *[REDAKTUAR]* ashtë në zonë të *[REDAKTUAR]* Ky s'ka dash me më tregu se në Zllash ka qenë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtës, ke bërë tre pyetje lidhur me të njëjtën gjë dhe nuk kemi marrë një përgjigje nga dëshmitari lidhur me këtë. Në qoftë se do më lejoni, dua ta bëj edhe një herë këtë pyetje sepse dua të di nëse përgjigja është "po" apo "jo". Zoti dëshmitar, *[REDAKTUAR]* vetë ta ka thënë që, "E kam çu *[REDAKTUAR]* në zonën e *[REDAKTUAR]*"? Dua që të më përgjigjesh me "po" ose "jo".

DËSHMITARI: Po, vetë më ka thanë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Personalisht?

DËSHMITARI: Personalisht, vetë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat, të lutem vazhdo.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. *[REDAKTUAR]* e çuan *[REDAKTUAR]*, siç e kuptova.

Pë. U arrestua *[REDAKTUAR]*.

Py. Po, këtë po përpiqem të them. Pyetja ime është kjo, cila është arsyeja që ai *[REDAKTUAR]*, ndërkohë që pjesa tjetër e *[REDAKTUAR]*?

Pë. Ai nuk ka mbet vetëm. Kanë qenë edhe nja shtatë a tetë djem të rinj, rrinin me i rujt shtëpiat.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. ...përsëri *[REDAKTUAR]*

Pë. E morëm lajmin që u arrestu. Por unë kam qenë i sigurt thoja, e kanë marrë e kanë vesh ushtar *[REDAKTUAR]* se ka qenë shumë trim. Ne nuk e kemi dit çfarë qëllimi u mor *[REDAKTUAR]*, derisa kemi gjet --. Të gjithë kena mendu se ashtë gjallë.

Py. E kuptoj. A e mësove ti ndonjëherë se kush ishin personat

e tjerë me *[REDAKTUAR]*
Pë. Jo. Dy djem të rinj, nuk e di kush janë. Emrat s'jua di.
Py. A e di ti në qoftë se *[REDAKTUAR]* ka shkuar për të gjetur *[REDAKTUAR]*, ka shkuar te dikush për të gjetur *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*
Pë. Po harroj, s'më kujtohet. Hiç s'më kujtohet.
Py. Po ndonjë anëtar tjetër i familjes? Tani, *[REDAKTUAR]* shkoi për të kërkuar *[REDAKTUAR]* kjo është e qartë.
A je në dijeni ti që ka pasur ndonjë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* që shkoi për të kërkuar *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Një herë, *[REDAKTUAR]* shku përditë. Gati përditë. A një herë ka shku dhe *[REDAKTUAR]* Edhe kanë taku *[REDAKTUAR]* tek shtabi aty. *[REDAKTUAR]* - i ka thanë, kemi ardh me pa *[REDAKTUAR]* i ka thanë, "Jo, *[REDAKTUAR]* s'keni me e pa ma kurrë". Dhe në fakt doli ashtu.
Py. Kush ta tha ty këtë gjë?
Pë. *[REDAKTUAR]*
Py. *[REDAKTUAR]*
Pë. *[REDAKTUAR]* Shumë e drejtë.
Py. Ju folët rreth një vendi ku shkuat dhe gjetët dokumente të *[REDAKTUAR]* atje. Dua që të flas me ty rreth këtij vendi.
Pë. Lirisht.
Py. Pyetja ime është kjo, a mund të na e përshkruani ju lutem, se si ishte ky vendi? Si dukej ky vendi?
Pë. Ashtë një shtëpi e braktisur. S'kish jetuar kurrkush aty,

se kanë ik prej katundi kanë shku në qytet. Edhe shtëpi e thatë, aty kishin ndejt ushtarët. Aty kishin pas shtabin, aty burgun. Shtëpia të vjetra, do farë stallash të thata krejt.

Py. A ishte e dëmtuar?

Pë. E vjetër, shumë e vjetër shtëpia edhe atëherë. E thatë e braktisur.

Py. A e di nëse ishte dëmtuar në luftime me serbët gjatë...

Pë. Jo, jo.

Py. ...kohës së ofensivës? Apo si?

Pë. Ajo shtëpi kishte qenë edhe kështu e vjetër, e dëmtume. Po dhe serbet, kish pas vrima plumbash plot. Po, edhe para--, e dëmtume, e vjetër shumë.

Py. A kishte godina, ndërtesa të tjera aty rreth e qark?

Pë. Ishin do shupa, do garazhe, do far pleme, do far kurrgjë. Shtëpia jo. Një hambar.

Py. Sa prej këtyre ahrave apo garazheve keni parë? Sa ahure apo sa garazhe keni parë, përpara se të mbërrinit në ndërtesën ku gjetët këtë dokumentin?

Pë. Ato garazhet edhe shupat e plemet, rend kanë qenë kështu, rend.

Py. Sa garazhe kishte?

Pë. Jo garazhe, do shupa ashtu për dru, për me lanë grunin, për me lanë lopët dhente. Ashtu rend kanë qenë.

Py. Sa prej këtyre kishte?

Pë. Nuk e di saktë sa kanë qenë. Aty ka qenë edhe bodrumi ku

i kanë mbajt të burgosurit, plus aty ka qenë njëfarë shupe e deleve edhe një tjetër diçka. Edhe një hambar ka qenë. Nuk di sa më thane krejt. Do shupa të vjetra, të këqija.

Py. E kuptoj që ishin shumë të vjetra. Thjesht dua të di sa ishin gjithë e gjithë. Pra gjithsej, sa struktura të tilla kishte?

Pë. Një hambar dhe nja dy shupa sikur të deleve diçka edhe ky bodrumi ku kishin qenë lopët.

Py. Pra, për sa behej fjalë për tre, për katër struktura gjithë-gjithë?

Pë. Tri a katër, s'e di vallahi. Ato janë rrëzuar tash, janë prish krejt.

Py. A jeni kthyer më?

Pë. Jo, kurrë.

Py. Nga e di që janë prish?

Pë. Atëherë kanë qenë të vjetra të këqija, e jo tash. E di që janë rrëzuar. Që 22 vjet.

Py. Sa ditë përpara ishte kjo se sa të shkonit e të zhvarrosnit trupin *[REDAKTUAR]*? D.m.th. sa ditë përpara shkuat tek ky vendi ku ...

Pë. Q'atë ditë që e kemi zbulu.

Py. ...ku i gjetët këto dokumente?

Pë. Q'atë ditë që e kemi zbulu kufomën. Kufomat të dyja. Qe atë ditë i kemi gjet dokumentet edhe vendin ku ka ndejt në stallë, aty poshtë. Se *[REDAKTUAR]* e dinte shtabin e rrugën,

se ai ka shkuar përditë atje. Unë e kam pas babën të palëvizshëm e nuk mundja me shku *[REDAKTUAR]*.
*[REDAKTUAR]*
Py. Dokumentet i gjete vetë ti, apo i gjeti *[REDAKTUAR]*?
Pë. E kam harru, nuk e di. Veç tek një dollap i kemi gjet. Po harroj a unë, *[REDAKTUAR]*, a kush i kemi pa ma së pari.
*[REDAKTUAR]* i ka marrë i ka shti në xhep. Edhe që atëherë, sot i pashë këtu.
Py. Ndërkohë që ju ishit vetë i pranishëm atë ditë që e bëri këtë gjë ai?
Pë. Po, po. Bashkë kemi qenë.
Py. Sa dhoma kishte aty? Ishte një dhomë, ishin disa dhoma? Sa ishin?
Pë. Një dhomë lart dhe bodrum poshtë edhe këtej ka qenë edhe diçka aty, po nuk e di ça. Veç një dhomë, një bodrum, aty i kemi gjet në dollap. Poshtë kishin qenë të burgosurit për fundi.
Py. E kuptoj. Por po flas për këtë ndërtesën, për këtë godinën që po përshkruan ti tani. Pra ju thoni që kishte një bodrum dhe kishte edhe një kat më sipër. Sa dhoma ishin tek ky kati mësipërm?
Pë. Kati i sipërm, unë nuk e di. Ne kemi hy vetëm në atë dhomën që kanë qenë të burgosurit për fundi. Më duket që dhe një dhomë tjetër ka qenë lidhur me të. Po harroj. Edhe një dhomë zaher mbrapa, veç hyrjen tjetër kah. Ashtu ka qenë.
Py. E kuptoj që kishte një hyrje tjetër, por po përpiqem të

kuptoj. Pra ju i gjetët dokumentet në një dhomë në katin sipërm. A ishte e vetmja dhomë kjo apo kishte dhoma të tjera? Pyetja ime është, kishte vetëm një dhomë sipër, apo jo?
Pë. Unë mendoj që mbi bodrum vetëm një dhomë. Tani, pa bodrum hiç, ka qenë edhe një dhomë diçka, por hyrjen më atë anë. Se ne në katund atje i bajmë ato odat për mysafir, e bajmë hyrjen e veçantë.
Py. Kjo dhoma ku i gjetët këto dokumente ose *[REDAKTUAR]*, ose ti ose *[REDAKTUAR]*, sa e madhe ishte kjo dhoma? Mesatarisht sa e madhe ishte dhoma?
Pë. S'e di. A katër me katër, a pesë me katër, diçka ka qenë. Jo e madhe. Nuk e di.
Py. E kuptoj. Pas kësaj ju gjetët varrin *[REDAKTUAR]*. Pyetja ime është kjo...
Pë. Masi e kemi kontrolluar shtëpinë, atëherë kemi dalë me kërkuar në fushë. Deri atë ditë e kemi lyp *[REDAKTUAR]* të gjallë. Atë ditë kemi shkuar me e gjet dikun të vdekur, se e kemi marrë vesh.
Py. Kjo fusha që ju përmendët, ishte rrafsh?
Pë. Rrafsh, mal ishte. Rrafsh ishte dhe mali ka qenë aty. Ka qenë një lëndinë me bar.
[Mbrojtja këshillohet]
Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e di nëse dëshmitari mund t'i heqë dëgjueset.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

dëshmitar, të lutem hiqi pak dëgjueset.

Faleminderit.

Z. VON BONE: [Përkthim] Thjeshtë doja të sigurohesha që të mos kemi diskutim të ri për "malin" edhe për "pyllin". Prandaj e bëra këtë gjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë po e diskutonim me njëri tjetrin.

Z. VON BONE: [Përkthim] Këtë thjesht doja ta sqaroja në mënyrë që të mos ngatërroheshe.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E mbaj mend shumë mirë këtë gjë.

Z. VON BONE: [Përkthim] Pyetjen tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të lutem vendosi edhe një herë dëgjueset.

Faleminderit zoti dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminderit edhe juve.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Zoti dëshmitar, nga ai vendi ku i gjetët dokumentet, pak a shumë, a dukej vendi ku ndodhej varri? D.m.th. jo tamam tamam ku ishte varri, por po të rrije në këmbë aty a dukej me sy të lirë?

Pë. Besoj, ngaqë shkon pak si mal, se nuk është shumë larg edhe rrafsh është. Por aty ka qenë një rreth e rreth mal e një copë lëndine e vogël. Aty ka qenë. Prej derës hyrjes e kam thanë 200 metra i ka pas, 100-150. Prej derës së hyrjes duket

ajo pjesë.

Py. Nuk e bllokonte shikim asgjë nga aty ku ndodheshit ju, deri tek varri?

Pë. Nuk po jam i sigurt se ka qenë një mal i vogël rrethit. Ai mal ka qenë krejt, po aty veç një far lëndine. Besoj që duket.

[Mbrojtja këshillohet]

Py. A mund ta përsërisni ju lutem përgjigjen sa i takon distancës, largësisë që thatë? Afërsisht.

Pë. Afërsisht...

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mjafton të lexojmë se çfarë ka thënë, e kemi në transkript, i është përgjigjur. Pastaj mund t'i bëni pyetje.

Se unë e shikoj këtu, nëse e keni fjalën për këtë, thotë: "Nga hyrja, më duket se ishte nja 200 a 250 metra".

Z. SHALA: Nga përgjigja mu duk sikur tha 150, jo 250.

DËSHMITARI: S'po e di as unë të sigurt. Përafërsisht.

Z. SHALA: Kjo është arsyeja pse e bëmë këtë pyetje.

Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Py. Dhe së fundmi për këtë vendndodhjen ku gjetët dokumentet, vendi ku gjetët dokumentet, a i kontrolluat ato ndërtesat, godinat e tjera nëse kishte ndonjë gjë në lidhje me këtë, d.m.th. a i kontrolluat ato ndërtesat e tjera?

Pë. I kontrolluam. Kurrgjë tjetër që vlen të fshehur nuk gjetëm. Atëherë shkuam ma larg, pak. Edhe e kemi gjet shpejt.

Py. Faleminderit shumë.
Kur shkuat tek vendi i varrit të *[REDAKTUAR]*, kur e patë fillimisht, çfarë patë?
Pë. Veç një tubë me dhé. Një tubë e madhe me dhé. Kurrgjë tjetër s'pamë.
Py. Bar, nuk kishte sipër?
Pë. Jo. Nuk kishte.
Py. A ju kuptova mirë, ishit me *[REDAKTUAR]* atë ditë...
Pë. Po.
Py. ...dhe ju të dy bashkë e zbuluat...
Pë. Bashkë.
Py. ...ama , apo --. Ta përsëris pyetjen, ta përfundoj.
Ishe ti bashkë *[REDAKTUAR]* që e zbuluat këtë vend ku e gjetët si përfundim *[REDAKTUAR]*?
Pë. Po. Po, bashkë *[REDAKTUAR]*.
Py. Para se të shkonit tek ai vendi ku e gjetët varrin, a shkuat në vende të tjera?
Pë. Ashtë sjell shumë pak rrethit, deri sa e pamë atë tubë me dhé. Se drejt ai s'i ka shku. Një herë e kena lyp rrethit rrethit, kur dikur e gjetëm tubë dhe shkuam aty.
Py. Atë ditë pastaj që bëtë zhvarrosjen ose kur po përpiqeshit të gjenit *[REDAKTUAR]*, në këtë tubë gjetët edhe një trup tjetër aty, kështu?
Pë. Po. Më së pari kemi gjet atë trupin tjetër. Tani, e kemi pa në fytyrë që nuk ashte ai. Kemi zbulu edhe pak ma shumë dhé

edhe e kemi gjet *[REDAKTUAR]*. Të dy bashkë kanë qenë ashtu.
Py. E kuptoj. Tani, jo për *[REDAKTUAR]* por për këtë tjetrin. Thatë më herët se kishte një moshë mesatare. Mesatare, në ç'kuptim kjo, "moshë mesatare"?
Pë. *[REDAKTUAR]* Tash s'po di unë *[REDAKTUAR]*, se fytyra ishte deformu. Veç *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. Faleminderit shumë. Si vepruat ju atë ditë, atë ditë që e gjetët varrin *[REDAKTUAR]*, si shkuat aty *[REDAKTUAR]*?
Pë. Aty shkuam me një traktor, se atëherë s'kishim mbas lufte menjëherë kurrgjë, një traktor. Edhe e zbuluam edhe u mërzitëm shumë. Edhe e mbuluam prapë me dhé edhe drejt shtëpisë.
Py. Për çfarë arsye nuk e morët që atë ditë trupin?
Pë. Edhe ishim vetëm unë *[REDAKTUAR]* edhe nuk e dishim a duhet me lajmëru dikun, a vjen dikush a. E lajmëruam dikën në UNMIK. Ata, pritëm nja dy ditë, s'erdh kurrkush. Kena shku vetë e kena zhvarros, e kemi pru. Ishte dikur menjëherë mbas lufte, ka qenë --. S'ka pas as pushtet, as polici. Veçse këta të UNMIK-u kanë qenë. Edhe këta kanë pas punë shumë.
Py. Shkove ti bashkë me *[REDAKTUAR]* tek UNMIK-u?
Pë. Jo. Jo, tek UNMIK-u jo.
Py. Po ku?
Pë. Nuk e di kurrë. Veç më ka thanë, "Kam lajmëruar, s'po vjen kurrkush. Po shkojmë po e zhvarrosim". Dhe kena shku.
Py. Siç e kuptoj unë, ti nuk e shoqërove *[REDAKTUAR]* që të

shkonte në UNMIK, apo jo?
Pë. Jo. S'di ça kam qenë i zanë, nuk e di. Nuk kam qenë me të atë ditë.
Py. Kur u larguat atë ditë, ditën kur e gjetët varrin...
Pë. Po.
Py. ...nuk e morët trupin atë ditë...
Pë. Jo.
Py. ...e latë, u larguat. A e shënuat atë vendndodhjen e varrit me një mënyrë a tjetër, që ta gjenit lehtë pastaj kur të ktheheshit?
Pë. Shumë lehtë aty, nuk ishte larg prej --. Dhe vendi rrafsh, shumë vend i përshtatshëm. Shumë lehtë me e gjet. Sot me shku besoj se e gjej.
Py. Herën e dytë që keni shkuar, e zhvarrosët *[REDAKTUAR]*, e çuat në varrin pastaj ku prehet...
Pë. Po.
Py. ...Desha vetëm pak të flasim për këtë momentin kur ndodhi zhvarrimi.
Thatë se, e fillove ti vetë...
Pë. Po.
Py. ...atë rrëmihjen, me rrëmih. Po pastaj kur e le ti, kush e vazhdoi?
Pë. Kena pru edhe diku, kam harru, 7-8 veta, sa kemi qenë kallaballëk. Edhe mua më kanë shty matanë edhe vetë e kanë zbulu ata. Nuk ka qenë thellë ajo, kaq thellë ishte. Më shumë

s'ka qenë. Kollaj ka qenë.
Py. Ditën e dytë kur u zhvarros trupi, identifikohej qartë që ishte *[REDAKTUAR]*, apo jo? Ishte e qartë?
Pë. Po, po. E qartë, e sigurt.
Py. Kishte ndonjë shenjë të veçantë në trup që ia kishe parë edhe ti vetë?
Pë. *[REDAKTUAR]* Edhe aty e kam njoft ma së pari. Edhe *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* po e vërtetoj *[REDAKTUAR]* Edhe në *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* i ka pas.
Py. Kur e zhvarroset trupin, a e kthyn njëherë përmbys me, për shembull si me thënë --. Apo siç u gjet, ashtu u mbajt?
Pë. Nuk mujt me thanë kurrgjë se s'më kanë lanë me u afru edhe kur e kanë nxjerrë në tabut. Kurrë s'e di. Jam ndier shumë keq atë ditë.
Py. Po, a e pe vetë, a e ke parë vetë apo jo? Me qenë se të largun?
Pë. Më larguan edhe janë afruar ata e kanë nxjerr aty edhe nuk e kam pa ma. Nuk e kam pa kur e kanë nxjerr, si e kanë nxjerr, nuk e di.
Py. Një ditë më parë e pe dhe ti, d.m.th. herën e parë e pe trupin *[REDAKTUAR]*
Pë. E zbuluam veç pak në fytyrë, e kemi zbuluar dhe ma shumë s'e kena prek asnjërin.
Py. Kishte ndonjë shenjë në kokë?

Pë. S'më kujtohet. Në fytyrë jo kështu. Veç me pas anash. Në fytyrë, jo. Nuk besoj. Kishte nis me u prish, me u deformu. Nuk kam vërejt shenjë.

Py. E kuptoj. Ditën e zhvarrosjes, a tha dikush ndonjë gjë, a përmendi dikush ndonjë shenjë që ia kishin gjet në trup?

Pë. Kanë thanë që do plumba ia kanë pa në shpinë. Unë vetë s'i kam pa. Kanë thanë nja tre plumba në shpinë. Se shpina ma nuk ishte prish. Se këtej lart ma e prish ishte kufoma. Shpina ma e mirë, ku me e dit ma ftohtë a.

Py. E pe vetë, apo e dëgjove?

Pë. E dëgjova prej tyre, thanë do plumba në shpinë.

Py. A di gjë, a bëri njeri fotografi të këtyre vrimave të plumbave?

Pë. Për vrimat nuk di. Ka pas aty ajo *[REDAKTUAR]* ka ba fotografi. Nuk e di a e ka ba shpinën, nuk e di.

Py. Më herët, sot më parë, po flisnim që gjete një dokument në atë vendin. A ia kontrolloi dikush xhepat, ti vetë apo dikush tjetër, *[REDAKTUAR]*?

Pë. Nuk besoj, nuk di. Atë e kam harru vallai. Se ne dokumentet i kena gjet në dollap, atje. Unë, xhepa nuk di.

Py. Kishte sende të tjera në trup? Sende të tijat që mund t'ia kenë marrë?

Pë. Kanë thanë do Puma i ka pas të shtrenjta të mira, ato s'i kish pas hiç. Tjetër nuk di. Tjetër s'më kujtohet.

Py. T'i kthehemi edhe një herë vendit ku i gjetët dokumentet

*[REDAKTUAR]* Më parë thatë se kjo dhoma ku i gjetët këtë, përdorej nga ushtarët.

Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse do t'jua japim më vonë se ku është thënë.

Py. Është e vërtetë kjo?

Pë. E vërtetë ashtë.

Py. Nga e dini ju këtë gjë?

Pë. Po e di se kena gjet edhe një regjistër të ushtarëve aty, regjistër që kanë dhanë roje ushtarët, a ça po di unë. Edhe *[REDAKTUAR]* e dinte atë vend aty se ka shkuar deri tek shtabi gati përditë, por s'e kanë lanë me pa *[REDAKTUAR]* hiç, se shkuam ne drejt aty.

Py. Nga e dini ju që kjo ishte lista e ushtarëve? Arrite vetë në përfundim, apo?

Pë. Me emra, nga katër ushtarë. Emrat, ndërrimet, pseudonimet. U dinte që ushtarë ishin. Regjistër.

Py. Nga e kuptoje vetëm nga emri që ishte ushtar?

Pë. Regjistër me emra, u dinte që ushtarë janë ata, sigurisht. Bile është edhe dikun në foto, ka qenë ajo regjistër. Veç emra, plot.

Py. E kuptoj, por nuk i dhatë përgjigje pyetjes sime. Pyetja ime është kjo: nga arritët ta kuptonit ju, thjeshtë vetëm nga emrat që këta ishin ushtarë?

Pë. Po se ushtarët kanë ndejt aty dhe aty në dollap është gjet ai dokument. U dinte që ushtarë janë ata.

Py. E kuptoj. Kush ju tha se aty qëndronin ushtarë? Nga e dinit ju këtë?

Pë. Dihet se shtabi ka qenë aty. *[REDAKTUAR]* kur ka shkuar herën e parë ka pyet dikë, ku ashtë shtabi. E kanë gjujt q'aty.

Py. Kush ishte në krye të këtij shtabi?

Pë. Nuk di. S'mujt me thanë kurrgjë. U përmend ky Salih Mustafa, nuk di kush, nuk jam i sigurt. S'jam i sigurt që ka qenë ky. Veç fjalë kam ndij.

Py. Shtabi i kujt ishte, ishte shtabi i policisë ushtarake, a i ndonjë grupi tjetër?

Pë. Nuk e di. Veç tjetër shtab aty s'ka pas. Veç ai ka qenë aty.

Py. Shtabi i kujt, i çfarë gjëje?

Pë. I ushtrisë, i policisë, a s'di unë për atë punë.

Py. Ti vetë nuk kishe qenë kurrë përpara tek ai vend, kështu është apo jo?

Pë. Kurrë.

Py. Kur *[REDAKTUAR]*, a e di nëse e kishin pranuar ta shihte *[REDAKTUAR]* në atë vend ndonjëherë?

Pë. Po, *[REDAKTUAR]* ka shkuar disa herë, por s'e kanë leju me e pa kurrë.

Py. Kush nuk e ka lejuar?

Pë. Ai roja që ka qenë aty, ça po di unë kush. Nuk e kanë lejuar me u afru bile tek shtabi.

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* S'e kanë lejuar hiç as me e pa, e jo me e liru.
Py. A i pe ndonjëherë fotografitë -- ta bëj dhe një herë pyetjen.
Ditën kur u bë zhvarrosja, kur e çuat *[REDAKTUAR]* në varrin ku prehet edhe sot, a i patë ndonjëherë fotografitë, a i pe ndonjëherë fotografitë e bëra gjatë zhvarrimit?
Pë. Jo fotografitë. Veçse kam pa ka bo fotografi. S'i kam pa kurrë.
Py. A u bënë fotografi të varrimit kur u varros në varrin ku edhe prehet?
Pë. Vallai po harroj. S'po më kujtohet. Kam harru. S'më kujtohet.
Py. A e dini pse u bënë në fakt fotografitë? Pse po bëheshin këto fotografi?
Pë. Normal për me e pas dokument. Dokument me e pas, ku u gjet, qysh u gjet. Me pas fakte. As e kena dit që na vijnë veç.
Py. Që të sigurohem. Ditën kur e gjetët *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* a ishte i pranishëm atë ditë kur e gjetët, apo jo?
Pë. Ditën e parë jo, kujtoj.
Py. Por ditën e dytë ishte i pranishëm, d.m.th. herën e dytë?
Pë. Herën e dytë.
Py. Thatë se nuk kishit dëgjuar kurrë për Salih Mustafën ose

që nga lajmet e keni marrë vesh për Salih Mustafën. A mundet
me na tregu se çfarë keni dëgjuar në lajme për Salih Mustafën?
Pë. Ka lajme që po akuzohet për do njerëz në atë zonën e
*[REDAKTUAR]*, Zllashit. Për Zllash, si u përmend Zllashi e kemi
dit që ashtë *[REDAKTUAR]* q'aty.
Py. Cila është lidhja këtu *[REDAKTUAR]*, çlidhje ka?
Pë. Salih Mustafa po akuzohet për dy viktima në katundin
Zllash. Edhe aty e kam dit *[REDAKTUAR]* ashtë aty. Të tjerë viktima
s'kam dit që ka. Se dy viktima janë në Zllash, me sa di.
Py. Sa kohë ka, d.m.th. tani vonë ka qenë lajmi? Sa vonë?
Pë. Për sa kohë nuk e di vallahi. Po harroj kur e keni nis ma
së pari.
Py. Është përmendur emri *[REDAKTUAR]* në lajme?
Pë. Jo, jo. Jo, nuk u përmend. Veç dy viktima në katundin e
Zllashit edhe u dinte. Unë menjëherë e kam dit që ashtë
*[REDAKTUAR]* dhe ai tjetri.
Py. E kishit dëgjuar ndonjëherë emrin e Salih Mustafës
përpara, d.m.th. gjatë kohës së luftës, flas?
Pë. Jo. Mas luftës e kam dëgju një Mustafa mbiemrin, edhe
Salih bile s'ia kam dit emrin. Një Mustafa, Mustafa e kam
dëgjuar.

Z. VON BONE: [Përkthim] Dëshiroj që të konsultohem një moment të nderuar Gjykatës.

[Mbrojtja këshillohet]

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Zoti dëshmitar edhe nja dy pyetje të tjera.
A mund të na tregoni *[REDAKTUAR]*

Pë. Nuk di me t'i shpjegu vallai. Veç në foto i kam çu unë. Janë diku në foto, se nuk i di unë. I kam diku.

Py. Dhe prej sa kohësh *[REDAKTUAR]*

Pë. Vallahi, goxha moti i marr. E tash *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Se kam pas problem me pagjumësinë, nuk mujsha me flejt, shfaqeshin do ëndrra, do zana, do gjurma. S'mujsha me flejt tanë natën. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* dikush i ka fotot.
S'di qysh thirren, vallai *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. Ke ndonjë trajtim, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, jo. *[REDAKTUAR]*

Py. Në spital, a je shtru ndonjëherë?
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. Sa kohë u bë që *[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]* i marr vallahi që nja, gati diku një vit e gjysmë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. Ju falënderoj për kohën zoti dëshmitar.

Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja Sekretare ju lutem a mund të na kaloni në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit.

Në pajtim me rregullat dhe udhëzimin e procesit gjyqësor, mund të lejojmë pyetje të mëtejshme plotësuese nga Prokuroria.

Prokuroria, ju lutem a mund të filloni me pyetje. A keni pyetje së pari?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, kemi disa pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi 15 minuta tani, por sigurisht që kemi dhe nesër kohën e nevojshme për këtë.

E keni ju fjalën tani.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do të përfundoj papara fundit të seancës së ditës së sotme.

Të nderuar Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë private për pyetjet e mia plotësuese?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të na kaloni në seancë private ju lutem.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Prokurore, ju lutem vazhdoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

Pyetje vijuese nga znj. D’Ascoli:

Py. Zoti dëshmitar, dua të sqaroj disa aspekte të burimit të informacionit lidhur me arrestimin *[REDAKTUAR]* dhe dua të sqaroj disa pika të cilat kanë të bëjnë me disa prej pyetjeve që ju bëri Avokati i Mbrojtjes lidhur me atë çfarë keni dëgjuar nga *[REDAKTUAR]*

Sot në mëngjes gjatë pyetjeve të Prokurorisë, dhe kjo reflektohet në faqen 17, rreshtat nga 1 në 12, unë ju pyeta se kush ju tregoi ju për arrestimin e *[REDAKTUAR]* Në përgjigje ju thatë që, ju e kishit dëgjuar këtë nga *[REDAKTUAR]*, që është *[REDAKTUAR]* A të kujtohet kjo?

Pë. Po. Ka qenë prezent ai me *[REDAKTUAR]* kur u arrestua.

Py. *[REDAKTUAR]* a të tregoi gjithashtu se kush e arrestoi *[REDAKTUAR]*

Pë. Po.

Py. A përmendi ndonjë emër ai?

Pë. *[REDAKTUAR]* Se e ka njoft, se kanë qenë prezent aty nja 7-8 vetë kur e kanë marrë. Edhe e ka njoh dikush *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* e ka kuptu që ashtë *[REDAKTUAR]*

Py. Në rregull. Faleminderit. Pra, me sa kuptoj unë, ju mësuat se *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Pë. Po, ashtu. Q'ashtu bash.
Py. Tani dua të kaloj tek pika ku ju u takuat me *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Ju thatë që më pas gjatë luftës --. Pra së pari, a ju kujtohet se kur ju ka ndodhur kjo, kur je takuar me *[REDAKTUAR]*
Pë. Gjatë bombardimeve. Nuk e di datën, e kam harru ditën. Veç kemi shkuar deri në Prishtinë bashkë *[REDAKTUAR]*. Në mbramje jemi taku në një vend, jemi ba tubë kena shku për Prishtinë bashkë. Aty e kam pa. Kurrë as përpara s'e kam njoft, as prej asaj dite kurrë s'e kam pa *[REDAKTUAR]*. Sot me e pa, s'e njof bile.
Py. Në rregull. Unë dua të sqaroj se çfarë ju tha ai lidhur me *[REDAKTUAR]*
    Në faqen 63 reflektohen disa pyetje lidhur me këtë çështje, faqe 63 rreshti nga 3 deri në 22. Dhe mendoj se në fund thatë se, pra përgjigja juaj ishte "Po". Kjo ishte përgjigja për pyetjen lidhur me faktin, në qoftë se *[REDAKTUAR]*
e kishte dërguar *[REDAKTUAR]* në zonën e *[REDAKTUAR]* A të kujtohet kjo?
Pë. Jo, vetëm fjalën më ka dhanë, si më ka thanë, "E kanë çu në zonë *[REDAKTUAR]*". Ajo s'kish qenë e vërtetë hiç.

Py. Në rregull. Sepse unë mendoj se kjo ishte e qartë në deklaratën që i keni dhënë UNMIK-ut.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në qoftë se do të më jepni leje të nderuar Gjykatës, do të doja të lexoja një pjesë të kësaj deklarate ku kjo shfaqet e qartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem vijoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të lexoj një segment të deklaratës së UNMIK-ut më datë 13 mars 2003, dokumenti me numër identifikimi SPOE0128189 deri në 00128290 [sipas përkthimit], do të lexoj deri në mes të faqes së parë të këtij dokumenti.

Py. Pyetja që ju është bërë është:

"Kur e takuat atë” lidhur me *[REDAKTUAR]* “çfarë i thatë ju atij dhe çfarë të tha ai ty”?

Dhe përgjigja që keni dhënë është kjo:

"Unë jam takuar *[REDAKTUAR]* në prill ose maj 1999. Unë isha me disa njerëz në *[REDAKTUAR]*, jashtë dhe dikush ma bëri me gisht në drejtim *[REDAKTUAR]*. Unë shkova *[REDAKTUAR]* dhe e pyeta, në qoftë se ai ishte *[REDAKTUAR]* dhe ai më tha që, “po ishte”. Unë e pyeta atë se çfarë kishte ndodhur *[REDAKTUAR]* dhe në qoftë se ai e dinte se ku ishte *[REDAKTUAR]* më tha që, *[REDAKTUAR]* ishte në rajonin e *[REDAKTUAR]*. Më pas e pyeta në qoftë se ishte i sigurt dhe ai më tha, po".

A keni ndonjë koment lidhur me këtë që sapo ju lexova?

Keni një sqarim për të bërë?
Pë. Shumë mirë, ashtu ka qenë. Edhe kurrë s'e kam pa *[REDAKTUAR]* Kurrë prej asaj dite. As e kam njoft përpara, as e kam pa ma.
Py. A është e saktë kjo që lexova unë, që ai iu tha ju që *[REDAKTUAR]* ishte në zonën *[REDAKTUAR]*
Pë. Shumë e saktë.
Py. Ndërkohë që informacioni që *[REDAKTUAR]* u arrestua edhe që *[REDAKTUAR]* kishte marrë pjesë në këtë arrestim, kishte ardhur nga *[REDAKTUAR]*, është e saktë kjo?
Pë. Po, e saktë. Se *[REDAKTUAR]* ka qenë prezent me të.
Py. Në rregull. Pra, *[REDAKTUAR]* të tha ty që, *[REDAKTUAR]* ishte në zonën *[REDAKTUAR]*. Jo që ai e kishte çuar *[REDAKTUAR]* në zonën *[REDAKTUAR]* është ë qartë kjo?
Pë. "E kanë çu në zonën *[REDAKTUAR]*", kështu ka thanë. I kam thanë, "A ashtë e sigurt *[REDAKTUAR]*"? Tha, "E sigurt shumë".
Unë u gëzova. [e pakuptueshme] në zonë të *[REDAKTUAR]* Ajo s'kishte qenë e vërtetë hiç.
Py. Në rregull. Faleminderit. Pra thjesht doja të sqaroja këtë pjesë të dëshmisë tuaj.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera të nderuar Gjykatës. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit zonja Prokurore.

Zonja Sekretare, a mund të kalojmë përsëri në seancë

publike ju lutem?

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtja e Viktimave, a keni pyetje të tjera?

ZNJ. ZEGVED: Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kemi pyetje të tjera.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

Zoti avokat kemi dy pyetje. Sa i takon referencave të përdorura, thatë që do t'i jepni këto referenca kur të mundeni, kështu që do doja t'ju kujtoja lidhur me to. Dhe pyetja tjetër është në qoftë se keni pyetje plotësuese për dëshmitarin.

Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera. Dhe referenca, nëse është e mundur, do t'jua sjell nesër në mëngjes. Mendoj që kanë të bëjnë me dy çështje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, keni të drejtë, kanë lidhje me dy çështje.

Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të bëj dhe një pyetje pak më vonë pa praninë e dëshmitarit në sallë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, patjetër. Unë gjithmonë bëj këtë gjë në fund të seancës, ju jap mundësinë palëve që të shprehen dhe të ngrenë çështje për

të cilat ata duan ta diskutojnë me Trupin Gjykues.

Në rregull atëherë. Shoh orën. Zoti dëshmitar, kemi mbërritur në fundin e ditës këtu në sallën e gjyqit, ndërkohë që do të vazhdojmë me marrjen tuaj në pyetje në orën 9.30 nesër në mëngjes. Nuk kemi përfunduar me dëshminë tuaj.

Faleminderit shumë për kohën dhe faleminderit për informacionin.

DËSHMITARI: Faleminderit dhe juve.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe më lejoni t'ju kujtoj se deri nesër, nuk duhet të flisni me askënd mbi dëshminë e dhënë këtu në gjyq. Besoj se e dini këtë gjë. Tani Sekretarja do t'ju ndihmojë dhe do t'ju nxjerrë nga salla e gjyqit. Shpresoj që mund të pushoni disi.

DËSHMITARI: Faleminderit shumë.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A keni ndonjë gjë për të ngritur zonja Prokurore?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kemi asgjë për të shtuar për momentin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Avokatja e Viktimave?

ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokati i të Akuzuarit, keni gjë për të thënë?

Z. VON BONE: [Përkthim] Thjeshtë dua një parashikim për kohën nesër, kur mendoni se mund të përfundojmë nesër. Kjo është pyetja që kam.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, zoti avokat. Për nesër mendoj se nuk do të përdorim më shumë se një seancë. Kjo është parashikimi për momentin sa i takon ditës së nesërme.

Në qoftë se palët dhe Mbrojtja për Viktimat nuk kanë gjë tjetër për të ngritur, atëherë do fillojmë sërish nesër. Kemi përfunduar këtu dhe si gjithmonë dua të falënderoj palët, Avokaten e Viktimave, por gjithashtu edhe përkthyesit, stenografët, personat që merren me pjesën audio vizive, por gjithashtu edhe stafin e sigurisë. Faleminderit.

Përfundojmë këtu për sot, do të fillojmë sërish nesër në orën 9.30.

--- Seanca mbyllet në orën 15.13